



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjensia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim (SDC)

INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

SHQIPËRI PROJEKSIONET E POPULLSISË 2011-2031



Maj, 2014

SHQIPËRI PROJEKSIONET E POPULLSISË, 2011-2031

Maj, 2014

Drejt看 Botimi:

Dr. Gjergji FILIPI

INSTAT

Blerina Subashi

Rudin Hoxha

Ogerta Elezaj

ASISTENCA TEKNIKE

Bukuri Dumani

Jonathan Zufferey

Mathias Lerch

Copyright © INSTAT 2014

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizim paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.



INSTITUTI I STATISTIKAVE

Blv. "Zhan D'Ark" Nr. 3, Tiranë

Tel : + 355 4 2222411 / 2233356

Fax : + 355 4 2228300

E-mail : info@instat.gov.al

Shtypshkronja:  Gent.grafik

Parathënie dhe falenderime

Censusi i Popullsisë dhe Banesave në vitin 2011 në Shqipëri, është i 11-i i kryer në historinë e censuseve të Shqipërisë. Përgatitja dhe zbatimi i këtij angazhimi kërkon një sasi të konsiderueshme burimesh financiare dhe njerëzore. Për këtë, INSTAT ka përfituar nga mbështetja e Qeverisë Shqiptare, Bashkimit Evropian dhe donatorëve ndërkombëtarë. Metodologjia e censurit është e bazuar në rekomandimet e EUROSTAT-it dhe të OKB-së për censuset e popullsisë dhe banesave të vitit 2010, duke marrë në konsideratë nevojat e veçanta të përdoruesve shqiptarë për të dhëna specifike.

INSTAT në bashkëpunim të ngushtë me donatorët e huaj ka iniciuar një proces analizimi më të thelluar të të dhënave të censurit, duke i krahasuar ato edhe me tregues të tjerë administrativë apo anketa të ndryshme. Analizat e thelluara të censurit të popullsisë dhe banesave 2011 do të shërbejnë më së miri në të ardhmen për të kuptuar dhe interpretuar më saktë karakteristikat e shoqërisë shqiptare. Informacioni që mbledhet nga censusi është multidimensional dhe në këto analiza shpreh disa risi si: tregu shqiptar i punës dhe struktura e tij, dinamikat e migracionit, tipologjia e ndarjes administrative, projeksionet e popullsisë si dhe karakteristikat e banesave dhe kushteve të banimit.

Seria e këtyre publikimeve ofron një pasqyrim të ri të gjendjes së shoqërisë shqiptare duke ndihmuar në kuptimin e mënyrave se si mund të investohet në infrastrukturë, si të ndihmohen autoritetet lokale nëpërmjet fenomeneve të urbanizimit duke patur parasysh ritmet e rritjes së popullsisë në të ardhmen, apo si të adresohen politikat në tregun e punës etj.

Të pesë botimet e kësaj serie janë analiza të thelluara të kryera nga INSTAT në bashkëpunim me Universitetin e Gjenevës, Universitetin e Neuchâtel dhe Institutin të Kërkimeve Urbane, dhe të mbështetura financiarisht nga SDC-Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

INSTAT gjen rastin të shprehë mirënjohje dhe falenderime për kontributin e çmuar të SDC- Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, ekspertëve të INSTAT dhe ekspertëve të tjerë vendas dhe të huaj në publikimin e serisë së analizave të censurit të popullsisë dhe banesave 2011.

Një falënderim i veçantë shkon për të gjithë institucionet dhe donatorët, të cilët kanë kontribuar në realizimin e censurit të popullsisë dhe banesave 2011, Qeverinë Shqiptare, Bashkimin Evropian (IPA 2009 dhe CARDS 2006), SIDA - Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar, SDC- Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, UNFPA - Fondin e Kombeve të Bashkuara për Popullsinë dhe UNDP - Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim.

Dr. Gjergji FILIPI

Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT



Lista e publikimeve tematike të Censurit 2011, Maj 2014

List of 2011 Census thematic publications, May 2014

- Censuri i Popullsisë dhe Banesave 2011: karakteristikat ekonomike
- 2011 Population and Housing Census: Economic Characteristics
- Dimensionet e cilësisë së Censurit 2011
- Quality Dimensions of the 2011 Population and Housing Census of Albania
- Kushtet e banimit dhe të jetesës
- Dwelling and living conditions
- Migracioni në Shqipëri
- Migration in Albania
- Një klasifikim i ri urban - rural i popullsisë shqiptare
- A new urban - rural classification of Albanian population
- Popullsia dhe dinamikat e saj - horizonte të reja demografike?
- Population and population dynamics in Albania - New demographic horizons?
- Projeksionet e popullsisë, 2011-2031
- Population Projections, 2011-2031
- Shqipëria 2011 Censuri në harta
- Albania 2011 Census Atlas
- Tipologjia e komunave dhe bashkive
- Communes and Municipalities Typology
- Lëvizjet vajtje-ardhje për qëllime punësimi
- Commuting from home to work
- Dinamikat e tregut të punës, 2001-2011
- Labour market dynamics, 2001-2011
- Aplikimi INSTATGIS – hartat në web (www.instatgis.gov.al)
- INSTATGIS – Atlas web application (www.instatgis.gov.al)

TABELA E PËRMBAJTJES

Kapitulli 1: Hyrje	11
Kapitulli 2: Tendencat më të fundit demografike në Shqipëri	15
Tendencat e popullsisë dhe të strukturës moshore	17
Lindshmëria	19
Vdekshmëria	21
Migrimi ndërkombëtar	22
Ndryshimet demografike në qarqet e Shqipërisë	24
Kapitulli 3: Metodologjia dhe hipotezat	25
Metodologjia e Projektioneve	27
Hipotezat për lindshmërinë, vdekshmërinë dhe migrimin në të ardhmen	28
<i>Hipotezat e lindshmërisë</i>	28
<i>Hipotezat e vdekshmërisë</i>	29
<i>Hipotezat për migrimin ndërkombëtar</i>	30
<i>Hipotezat për migrimin e brendshëm</i>	32
Skenarët	33
Kapitulli 4: Rezultatet	35
Tendencat e ardhshme të popullsisë së Shqipërisë	37
<i>Popullsia sipas grupmoshave</i>	39
<i>Struktura moshore</i>	40
<i>Moshimi i popullsisë në Shqipëri</i>	41
Vlerësimi i ndjeshmërisë së projeksioneve ndaj hipotezave	42
Skenari i rritjes së mesme i shtrirë deri në vitin 2060	43
Projeksionet e popullsisë në nivel qarku	45
Kapitulli 5: Konkluzionet	49
Kapitulli 6: Shtojcat	53
Shtojca 1: Fjalorthi dhe metodat	55
<i>Fjalorth</i>	55
<i>Metodat</i>	56
Shtojca 2: Ndryshimi demografik në qarqet e Shqipërisë (analizë e detajuar)	57
Shtojca 3: Tabelat e hipotezave të projeksioneve të popullsisë në nivel kombëtar	62
Shtojca 4: Tabelat e projeksioneve të popullsisë në nivel kombëtar	78
Rezultatet përmbledhëse të projeksioneve të popullsisë në nivel kombëtar për Shqipërinë në vitet 2011-2031	78
Rezultatet e projeksioneve të popullsisë në nivel kombëtar: skenari i rritjes së ulët (vdekshmëri e lartë, lindshmëri e ulët dhe migrim i lartë), sipas moshës për Shqipërinë në vitet 2011-2031	82

Rezultatet e projeksioneve të popullsisë në nivel kombëtar: skenari i rritjes së mesme (vdekshmëri, lindshmëri dhe migrim i mesëm), sipas moshës për Shqipërinë në vitet 2011-2060	96
Rezultatet e projeksioneve të popullsisë në nivel kombëtar: skenari i rritjes së lartë (vdekshmëri e ulët, lindshmëri e lartë dhe migrim i ulët), sipas moshës për Shqipërinë në vitet 2011-2031	128
Rezultatet e projeksioneve të popullsisë në nivel kombëtar: skenari i rritjes së ulët (vdekshmëria e lartë, lindshmëria e ulët dhe migrimi i lartë), sipas grupmoshave 5 vjeçare për Shqipërinë në vitet 2011-2031	140
Rezultatet e projeksioneve të popullsisë në nivel kombëtar: skenari i rritjes së mesme (vdekshmëri, lindshmëri dhe migrim i mesëm), sipas grupmoshave 5 vjeçare për Shqipërinë në vitet 2011-2031	146
Rezultatet e parashikimit të popullsisë në nivel kombëtar: skenari i rritjes së lartë (vdekshmëri e ulët, lindshmëri e lartë dhe migrim i ulët), sipas grupmoshave 5 vjeçare për Shqipërinë në vitet 2011-2031	152
Shtojca 5: Tabelat e hipotezave të projeksioneve të popullsisë sipas qarqeve (skenari i rajonalizuar i rritjes së mesme)	158
Shtojca 6: Tabelat e projeksioneve të popullsisë sipas qarqeve	172
Rezultatet përmbljedhëse të projeksioneve të popullsisë sipas qarqeve për Shqipërinë për vitet 2011-2031	172
Rezultatet e projeksioneve të popullsisë sipas skenarit të rajonalizuar të rritjes së mesme dhe migrimit të brendshëm të mesëm, me grupmosha 5 vjeçaresipas qarqeve, 2011-2031	184
Referencat	197

Lista e Tabelave

Tabela 1. <i>Struktura moshore e popullsisë së Shqipërisë, Censuset 1979-2011, në (%)</i>	18
Tabela 2. <i>Hipotezat e lindshmërisë së lartë, të mesme dhe të ulët në Shqipëri për vitet 2011-2031</i>	29
Tabela 3. <i>Hipotezat e vdekshmërisë foshnjore të ulët, të mesme dhe të lartë (për 1.000 lindje të gjalla) për periudhën 2011-2031</i>	30
Tabela 4. <i>Jetëgjatësia në lindje sipas hipotezave për vdekshmërinë e ulët, të mesme dhe të lartë</i>	30
Tabela 5. <i>Hipoteza e ulët e migrimit ndërkombëtar (indeksi sintetik i emigrimit dhe numri i imigrantëve), 2011-2031</i>	31
Tabela 6. <i>Hipoteza e mesme e migrimit ndërkombëtar (indeksi sintetik i emigrimit dhe numri i imigrantëve), 2011-2060</i>	31
Tabela 7. <i>Hipoteza e lartë e migrimit ndërkombëtar (indeksi sintetik i emigrimit dhe numri i imigrantëve), 2011-2031</i>	32

Lista e Figurave

Figura 1. <i>Popullsia dhe norma e rritjes së saj (në %) në Shqipëri për periudhën 1923-2011</i>	17
Figura 2. <i>Piramidat e popullsisë së Shqipërisë sipas Censurit 2001 dhe 2011</i>	18
Figura 3. <i>Tendencat e indeksit sintetik të fertilitetit (ISF) për Shqipërinë 1980-2012</i>	19
Figura 4. <i>Koeficientët specifikë të lindshmërisë (për mijë), Shqipëria 1960-2011</i>	20
Figura 5. <i>Jetëgjatësia mesatare në lindje (e0) dhe koeficientët specifikë të vdekshmërisë sipas gjinisë, 1989, 2001 dhe 2011</i>	21
Figura 6. <i>Normat mesatare vjetore të emigrimit sipas gjinisë dhe moshës për Shqipërinë 1989-2001 dhe 2001-2011 (për ‰)</i>	23

Figura 7. Të kthyerit në Shqipëri në vitin 2011 sipas grupmoshës dhe gjinisë	23
Figura 8. Tendencat në numrin (ana e majtë) dhe normë e rritjes (ana e djathtë) të popullsisë së Shqipërisë 1989-2031	37
Figura 9. Tendencat e numrit të lindjeve dhe të vdekjeve, rritjes natyrore dhe migrimit neto, 2011-2031	38
Figura 10. Ndryshimi i numrit të popullsisë sipas grupmoshave, 1989-2031	39
Figura 11. Piramidat e popullsisë së Shqipërisë për vitin 2011, 2021 dhe 2031	40
Figura 12. Ndryshimi i moshës medianë të popullsisë dhe i koeficientëve të varësisë të të rinjve dhe të të moshuarve, për vitet 1989-2031	41
Figura 13. Tendenda e numrit të popullsisë sipas skenarit të rritjes së mesme dhe varianteve të tij për vitet 1989-2031	42
Figura 14. Tendenda e numrit të përgjithshëm të popullsisë, popullsisë në moshë pune, të rinjve dhe të moshuarve në vitet 2011-2060	43
Figura 15. Norma e rritjes, numri i rritjes natyrore dhe migrimi neto, 2011-2060	44
Figura 16. Koeficienti i varësisë të të rinjve dhe të të moshuarve dhe piramidat e popullsisë për vitet 2011-2060	44
Figura 17. Ndryshimi i popullsisë së përgjithshme dhe popullsisë në moshë pune (moshat 15-64 vjeç) sipas tre skenarëve të migrimit të brendshëm për qarqet e Shqipërisë, 2011-2031	45
Figura 18. Raporti i popullsisë së qarqeve në vitin 2031 ndaj asaj të vitit 2011 dhe përpjesat e popullsisë së tyre ndaj totalit kombëtar sipas tre skenarëve të migrimit të brendshëm, 2011-2031	46
Figura 19. Koeficienti i varësisë të të moshuarve sipas tre skenarëve të migrimit të brendshëm për qarqet e Shqipërisë për vitet 2011-2031	46
Figura 20. Piramidat e popullsisë (në %) për qarqet e Shqipërisë për vitet 2001 dhe 2011	57
Figura 21. Normat e migrimit të jashtëm ndërmjet qarqeve sipas grupmoshës dhe gjinisë, 2000-01 dhe 2010-11	61

Lista e Tabelave të Shtojcave

Shtojca, Tabela 1. Treguesit demografikë për qarqet e Shqipërisë, 2001-2011	59
Shtojca, Tabela 2. Koeficientët specifikë të vdekshmërisë sipas gjinisë, hipoteza e mesme e vdekshmërisë, 2011 - 2031	62
Shtojca, Tabela 3. Koeficientët specifikë të lindshmërisë, hipoteza e ulët e lindshmërisë, 2011 - 2031	65
Shtojca, Tabela 4. Koeficientët specifikë të lindshmërisë, hipoteza e mesme e lindshmërisë, 2011 - 2031	66
Shtojca, Tabela 5 . Koeficientët specifikë të lindshmërisë, hipoteza e lartë e lindshmërisë, 2011 - 2031	67
Shtojca, Tabela 6. Koeficientët specifikë të migrimit ndërkombëtar, hipoteza e ulët e migrimit, 2011 - 2031	68
Shtojca, Tabela 7. Koeficientët specifikë të migrimit ndërkombëtar, hipoteza e mesme e migrimit, 2011 - 2031	71
Shtojca, Tabela 8. Koeficientët specifikë të migrimit ndërkombëtar, hipoteza e lartë e migrimit, 2011 - 2031	74
Shtojca, Tabela 9. Shpërndarja e imigrantëve në përqindje sipas moshës dhe gjinisë, 2011	77
Shtojca, Tabela 10. Projektionet e popullsisë në nivel kombëtar – Rezultate përmbledhëse për vitin 2021 dhe 2031	78
Shtojca, Tabela 11. Projektionet e popullsisë së Shqipërisë sipas moshës (të dy gjinitë), skenari i rritjes së ulët (vdekshmëri e lartë, lindshmëri e ulët dhe migrim i lartë), 2011 - 2031	82
Shtojca, Tabela 12. Projektionet e popullsisë së meshkujve të Shqipërisë sipas moshës, skenari i rritjes së ulët (vdekshmëri e lartë, lindshmëri e ulët dhe migrim i lartë), 2011 - 2031	86
Shtojca, Tabela 13. Projektionet e popullsisë së femrave të Shqipërisë sipas moshës, skenari i rritjes së ulët (vdekshmëri e lartë, lindshmëri e ulët dhe migrim i lartë), 2011 - 2031	90
Shtojca, Tabela 14. Projektionet e popullsisë së Shqipërisë sipas moshës (të dy gjinitë), skenari i rritjes së mesme (vdekshmëri, lindshmëri dhe migrim i mesëm), 2011 - 2060	96

Shtojca, Tabela 15. <i>Projeksionet e popullsisë së meshkujve të Shqipërisë sipas moshës, skenari i rritjes së mesme (vdekshmëri, lindshmëri dhe migrim mesëm), 2011 – 2060</i>	106
Shtojca, Tabela 16. <i>Projeksionet e popullsisë së femrave të Shqipërisë sipas moshës, skenari i rritjes së mesme (vdekshmëri, lindshmëri dhe migrim mesëm), 2011 – 2060</i>	116
Shtojca, Tabela 17. <i>Projeksionet e popullsisë së Shqipërisë sipas moshës (të dy gjinitë), skenari i rritjes së lartë (vdekshmëri e ulët, lindshmëri e lartë dhe migrim i ulët), 2011 – 2031</i>	128
Shtojca, Tabela 18. <i>Projeksionet e popullsisë së meshkujve të Shqipërisë sipas moshës, skenari i rritjes së lartë (vdekshmëri e ulët, lindshmëri e lartë dhe migrim i ulët), 2011 – 2031</i>	132
Shtojca, Tabela 19. <i>Projeksionet e popullsisë së femrave të Shqipërisë sipas moshës, skenari i rritjes së lartë (vdekshmëri e ulët, lindshmëri e lartë dhe migrim i ulët), 2011 – 2031</i>	136
Shtojca, Tabela 20. <i>Projeksionet e popullsisë së Shqipërisë me grupmosha pesë vjeçare (të dy gjinitë), skenari i rritjes së ulët, 2011 – 2031</i>	140
Shtojca, Tabela 21. <i>Projeksionet e popullsisë së meshkujve të Shqipërisë me grupmosha pesë vjeçare, skenari i rritjes së ulët, 2011 – 2031</i>	142
Shtojca, Tabela 22. <i>Projeksionet e popullsisë së femrave të Shqipërisë me grupmosha pesë vjeçare, skenari i rritjes së ulët, 2011 – 2031</i>	144
Shtojca, Tabela 23. <i>Projeksionet e popullsisë së Shqipërisë me grupmosha pesë vjeçare (të dy gjinitë), skenari i rritjes së mesme, 2011 – 2031</i>	146
Shtojca, Tabela 24. <i>Projeksionet e popullsisë së meshkujve të Shqipërisë me grupmosha pesë vjeçare, skenari i rritjes së mesme, 2011 – 2031</i>	148
Shtojca, Tabela 25. <i>Projeksionet e popullsisë së femrave të Shqipërisë me grupmosha pesë vjeçare, skenari i rritjes së mesme, 2011 – 2031</i>	150
Shtojca, Tabela 26. <i>Projeksionet e popullsisë së Shqipërisë me grupmosha pesë vjeçare (të dy gjinitë), skenari i rritjes së lartë, 2011 – 2031</i>	152
Shtojca, Tabela 27. <i>Projeksionet e popullsisë së meshkujve të Shqipërisë me grupmosha pesë vjeçare, skenari i rritjes së lartë, 2011 – 2031</i>	154
Shtojca, Tabela 28. <i>Projeksionet e popullsisë së femrave të Shqipërisë me grupmosha pesë vjeçare, skenari i rritjes së lartë, 2011 – 2031</i>	156
Shtojca, Tabela 29. <i>Normat pesë vjeçare të mbijetesës sipas grupmoshave pesë vjeçare dhe gjinisë, për qarqet e Shqipërisë, sipas hipotezës së mesme, 2011 – 2031</i>	158
Shtojca, Tabela 30. <i>Koeficientët specifikë të lindshmërisë (grupmosha pesë vjeçare), për intervale pesë vjeçare, për qarqet e Shqipërisë, sipas hipotezës së mesme, 2011 – 2031</i>	159
Shtojca, Tabela 31: <i>Koeficientët specifikë të emigrimit të meshkujve (grupmosha pesë vjeçare), për intervale pesë vjeçare, për qarqet e Shqipërisë, sipas hipotezës së mesme, 2011 – 2031</i>	160
Shtojca, Tabela 32. <i>Koeficientët specifikë të emigrimit të femrave (grupmosha pesë vjeçare), për intervale pesë vjeçare, për qarqet e Shqipërisë, sipas hipotezës së mesme, 2011 – 2031</i>	163
Shtojca, Tabela 33. <i>Koeficientët specifikë të emigrimit të brendshëm të meshkujve (grupmosha pesë vjeçare), për intervale pesë vjeçare, për qarqet e Shqipërisë, sipas hipotezës së mesme të emigrimit të brendshëm, 2011 – 2031</i>	166
Shtojca, Tabela 34. <i>Koeficientët specifikë të emigrimit të brendshëm të femrave (grupmosha pesë vjeçare), për intervale pesë vjeçare, për qarqet e Shqipërisë, sipas hipotezës së mesme (konstante) të emigrimit të brendshëm, 2011 – 2031</i>	167
Shtojca, Tabela 35. <i>Shpërndarja e imigrantëve ndërkombëtar meshkuj, me grupmosha pesë vjeçare, për qarqet e Shqipërisë, sipas hipotezës së mesme, 2011 – 2031</i>	168
Shtojca, Tabela 36. <i>Shpërndarja e imigrantëve ndërkombëtar femra, me grupmosha pesë vjeçare, për qarqet e Shqipërisë, sipas hipotezës së mesme, 2011 – 2031</i>	169
Shtojca, Tabela 37. <i>Shpërndarja e emigrantëve të brendshme meshkuj, me grupmosha pesë vjeçare, për qarqet e Shqipërisë, sipas hipotezës së mesme (konstante) të migrimit të brendshëm, 2011 – 2031</i>	170
Shtojca, Tabela 38. <i>Shpërndarja e emigrantëve të brendshme femra, me grupmosha pesë vjeçare, për qarqet e Shqipërisë, sipas hipotezës së mesme (konstante) të migrimit të brendshëm, 2011 – 2031</i>	171

Shtojca, Tabela 39. Rezultatet përmbledhëse të projeksioneve të popullsisë për qarkun e Beratit, 2011 – 2031	172
Shtojca, Tabela 40. Rezultatet përmbledhëse të projeksioneve të popullsisë për qarkun e Dibrës, 2011 – 2031	173
Shtojca, Tabela 41. Rezultatet përmbledhëse të projeksioneve të popullsisë për qarkun e Durrësit, 2011 – 2031	174
Shtojca, Tabela 42. Rezultatet përmbledhëse të projeksioneve të popullsisë për qarkun e Elbasanit, 2011 – 2031	175
Shtojca, Tabela 43. Rezultatet përmbledhëse të projeksioneve të popullsisë për qarkun e Fierit, 2011 – 2031	176
Shtojca, Tabela 44. Rezultatet përmbledhëse të projeksioneve të popullsisë për qarkun e Gjirokastrës, 2011 – 2031	177
Shtojca, Tabela 45. Rezultatet përmbledhëse të projeksioneve të popullsisë për qarkun e Korçës, 2011 – 2031	178
Shtojca, Tabela 46. Rezultatet përmbledhëse të projeksioneve të popullsisë për qarkun e Kukësit, 2011 – 2031	179
Shtojca, Tabela 47. Rezultatet përmbledhëse të projeksioneve të popullsisë për qarkun e Lezhës, 2011 – 2031	180
Shtojca, Tabela 48. Rezultatet përmbledhëse të projeksioneve të popullsisë për qarkun e Shkodrës, 2011 – 2031	181
Shtojca, Tabela 49. Rezultatet përmbledhëse të projeksioneve të popullsisë për qarkun e Tiranës, 2011 – 2031	182
Shtojca, Tabela 50. Rezultatet përmbledhëse të projeksioneve të popullsisë për qarkun e Vlorës, 2011 – 2031	183
Shtojca, Tabela 51. Projektionet e popullsisë sipas skenarit të rajonalizuar të rritjes së mesme dhe hipotezës së mesme të migrimit të brendshëm për qarkun e Beratit, 2011 – 2031	184
Shtojca, Tabela 52. Projektionet e popullsisë sipas skenarit të rajonalizuar të rritjes së mesme dhe hipotezës së mesme të migrimit të brendshëm për qarkun e Dibrës, 2011 – 2031	185
Shtojca, Tabela 53. Projektionet e popullsisë sipas skenarit të rajonalizuar të rritjes së mesme dhe hipotezës së mesme të migrimit të brendshëm për qarkun e Durrësit, 2011 – 2031	186
Shtojca, Tabela 54. Projektionet e popullsisë sipas skenarit të rajonalizuar të rritjes së mesme dhe hipotezës së mesme të migrimit të brendshëm për qarkun e Elbasanit, 2011 – 2031	187
Shtojca, Tabela 55. Projektionet e popullsisë sipas skenarit të rajonalizuar të rritjes së mesme dhe hipotezës së mesme të migrimit të brendshëm për qarkun e Fierit, 2011 – 2031	188
Shtojca, Tabela 56. Projektionet e popullsisë sipas skenarit të rajonalizuar të rritjes së mesme dhe hipotezës së mesme të migrimit të brendshëm për qarkun e Gjirokastrës, 2011 – 2031	189
Shtojca, Tabela 57. Projektionet e popullsisë sipas skenarit të rajonalizuar të rritjes së mesme dhe hipotezës së mesme të migrimit të brendshëm për qarkun e Korçës, 2011 – 2031	190
Shtojca, Tabela 58. Projektionet e popullsisë sipas skenarit të rajonalizuar të rritjes së mesme dhe hipotezës së mesme të migrimit të brendshëm për qarkun e Kukësit, 2011 – 2031	191
Shtojca, Tabela 59. Projektionet e popullsisë sipas skenarit të rajonalizuar të rritjes së mesme dhe hipotezës së mesme të migrimit të brendshëm për qarkun e Lezhës, 2011 – 2031	192
Shtojca, Tabela 60. Projektionet e popullsisë sipas skenarit të rajonalizuar të rritjes së mesme dhe hipotezës së mesme të migrimit të brendshëm për qarkun e Shkodrës, 2011 – 2031	193
Shtojca, Tabela 61. Projektionet e popullsisë sipas skenarit të rajonalizuar të rritjes së mesme dhe hipotezës së mesme të migrimit të brendshëm për qarkun e Tiranës, 2011 – 2031	194
Shtojca, Tabela 60. Projektionet e popullsisë sipas skenarit të rajonalizuar të rritjes së mesme dhe hipotezës së mesme të migrimit të brendshëm për qarkun e Vlorës, 2011 – 2031	195

1

Hyrje

Projeksionet e popullsisë japin informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit social ekonomik dhe studimin e tregut. Ky raport prezanton rezultatet e ciklit të tretë të projeksioneve të popullsisë të INSTAT-it. Cikli i parë bazohej në Censusin e vitit 1989 dhe u realizua në nivel kombëtar për një periudhë prej 21 vitesh (popullsia e rajoneve u vlerësua për një periudhë prej pesë vitesh). Këto parashikime më pas u përditësuan duke u bazuar në Censusin 2001 dhe u shtrinë deri në vitin 2021, për vendin dhe katër rajonet e tij (INSTAT 2004b). Në atë kohë, popullsia e Shqipërisë u përfshi në lëvizje të brendshme dhe ndërkombëtare në shkallë të gjerë (më tutje të quajtura emigrim brenda vendit ose imigrim brenda vendit si dhe emigrim ose imigrim, respektivisht), dhe gjithashtu u reduktua në mënyrë të konsiderueshme numri i lindjeve.

Këto tendenca demografike vazhduan edhe në vitet 2000. Migrimi ndërkombëtar vazhdoi dhe ishte i shpërndarë në të gjithë vendin, duke çuar drejt një rënieje të vazhdueshme të popullsisë së Shqipërisë, veçanërisht në zonat kufitare. Kjo u shoqërua me lëvizjet e brendshme, të cilat rritën përqendrimin e banorëve në zonat urbane, veçanërisht në Tiranë. Të gjitha qarqet u përfshinë në një trend lindshmërie të ulët, i cili nuk garanton më riprodhimin demografik të popullsisë në të ardhmen. Efektet e kombinuara të lindshmërisë së ulët dhe largimeve në shkallë të gjerë, kryesisht të rinjve, përsheptuan ritmin e moshimit të popullsisë. Ky cikël i tretë i projeksioneve të popullsisë synon të japë informacion në lidhje me tendencat më të mundshme të zhvillimeve demografike në Shqipëri në të ardhmen dhe vlerëson pasojat mbi popullsinë e qarqeve dhe popullsinë në nivel kombëtar sipas moshës dhe gjinisë deri në vitin 2031, bazuar në Censusin e fundit të popullsisë në vitin 2011.

Vështirësia e parashikimit në një kontekst demografik kaq dinamik, tregohet nga mbivlerësimi i numrit të popullsisë në projeksionet e mëparshme për vitet 2010/11, në krahasim me numrin e popullsisë në Censusin 2011¹. Përveç pasigurisë në evolucionin e ardhshëm të sjelljes demografike, konteksti social ekonomik mbetet gjithashtu jo i qartë. Megjithatë Shqipëria i përket atyre pak vendeve Evropiane që nuk kanë provuar recesion që nga viti 2008, vendet kryesore të destinacionit të emigrantëve aktualisht përballen me një krizë politike, strukturore dhe financiare. Zgjatja e kësaj krize do të ndikojë në ecurinë e ardhshme të migrimit Shqiptar me pasoja domethënëse jo vetëm mbi popullsinë, por gjithashtu edhe mbi jetën e familjeve dhe zhvillimin ekonomik në vend nëpërmjet ndryshimit të sasive të parave të dërguara nga jashtë vendit.

Duke pasur parasysh këtë situatë, në fillim u bë një analizë e tendencave të popullsisë në të kaluarën, në nivel kombëtar dhe sipas qarqeve, duke përfshirë edhe krahasime ndërkombëtare, në mënyrë që të krijoheshin e hipotezat bazë të projeksioneve. Kjo u bë e mundur nga rritja e disponueshmërisë të të dhënave demografike prodhuar nga INSTAT-i gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit, duke mundësuar një matje më të saktë të historisë demografike të Shqipërisë që pas vitit 1989. Kjo punë përgatitore, kombinuar me pritshmëritë rreth perspektivave të zhvillimit politik dhe social ekonomik të Shqipërisë, formon bazën për supozimet e tendencave demografike në të ardhmen. Periudha e parashikimit kufizohet në 20 vjet deri në vitin 2031, dhe tre skenarë të ndryshëm japin informacion për prirjet e popullsisë (skenari i mesëm shtrihet deri në vitin 2060). Krahasuar me projeksionet e mëparshme të INSTAT-it, ky cikël i tretë përdor një metodologji pak më të ndryshme për një parashikim më të mirë të emigrimit dhe gjeografikisht është më i disagreguar mbi rezultatet jepen për çdo qark të Shqipërisë.

Seksioni i pasardhës rishikon shkurtimisht tendencat demografike në Shqipëri dhe qarqet e saj. Më pas prezantohet metodologjia e projeksioneve dhe diskutohen hipotezat mbi lindshmërinë, vdekshmërinë dhe migrimin, të cilat kombinohen në tre skenarë të ndryshimit të popullsisë në nivel kombëtar. Skenari i rritjes së mesme më pas rajonalizohet dhe diferencohet në tre skenarë të migrimit të brendshëm për projeksionet e popullsisë së qarqeve të Shqipërisë. Parashikimet në nivel qarku dhe nivel kombëtar përshkruhen dhe diskutohen, analizohet ndjeshmëria e tyre ndaj hipotezave dhe identifikohen komponentët kryesorë të ndryshimeve demografike të ardhshme në Shqipëri. Raporti mbyllet me një përmbledhje të rezultateve kryesore.

⁽¹⁾ Ciklet e para dhe të dytë prisnin respektivisht 3,8 dhe 3,2 milion banorë përkundrejt një numri të vlerësuar prej 2,9 milionësh.


2

Tendencat më të fundit demografike në Shqipëri

TENDENCAT E POPULLSISË DHE TË STRUKTURËS MOSHORE

Shqipëria provoi një fillim të vonë por me një ritëm të shpejtë të tranzicionit demografik (d.m.th. rënia e vazhdueshme e niveleve të vdekshmërisë dhe lindshmërisë). Nëse vdekshmëria filloi të bjerë që nga vitet 1930, lindshmëria mbeti e lartë deri në vitet 1960. Për rrjedhojë vendi shfaqti një ndër ritmet më të larta të rritjes në Evropën e pas luftës (mbi 2% në vit), duke çuar drejt një rritjeje nga 1.218 mijë banorë në vitin 1950 në një maksimum prej 3.182 mijë në vitin 1989 (Figura 1). Megjithatë, pavarësisht nga struktura e re moshore, popullsia u reduktua në 3.069 mijë në vitin 2001 dhe 2.907 në vitin 2011, e cila korrespondon me një rënie vjetore prej 0,3 dhe 0,8%, respektivisht. Emigrimi dhe ulja e lindshmërisë ishin përcaktuesit kryesorë të këtij reduktimi të popullsisë.

Figura 1. Popullsia dhe norma e rritjes së saj (në %) në Shqipëri për periudhën 1923-2011




Burimet : Censuset e Popullsisë së Shqipërisë.

Si në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, ndryshimet e sjelljes tek lindshmëria dhe migrimi kanë prekur në mënyrë të ndjeshme strukturën e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë në Shqipëri. (Figura 2). Forma e parregullt e piramidës së popullsisë dëshmon se si sjellja demografike në të kaluarën ndikoi në madhësinë e brezave të njëpasnjëshëm të të lindurve që mbijetojnë brenda Shqipërisë (Figura2). Thyerjet në formën e piramidës në mesin e saj dëshmojnë për emigrimin e lartë të të rinjve, veçanërisht të meshkujve.

Në krahasim me vitin 2001, kur gratë ishin më të shumta në numër se burrat për shkak të një dominimi të meshkujve në emigrim, numrat janë më të balancuar në vitin 2011 për shkak të një pjesëmarrjeje në rritje të grave në fenomenin e migrimit veçanërisht ndër të rinjtë. Në të vërtetë, ekziston një mbi-përfaqësim i meshkujve në popullsinë e moshës 20-29 (raporti gjinor është 111 meshkuj për çdo 100 femra).

Brezat në moshën e lindjes së fëmijëve (20-44 vjeç) jo vetëm u paksuan nga migrimi në shkallë të gjerë, por kishin gjithashtu edhe një lindshmëri të ulët. Ndërsa numri i lindjeve vinte duke u ulur, baza e piramidës ngushtohet. Gjithashtu është i dukshëm një mbipërfaqësim i djemve kundrejt vajzave. Kjo mund të lidhet me rritjen e shpejtë të raportit gjinor në lindje (110 lindje meshkujsh kundrejt 100 lindjeve të femrave në vitin 2010), e cila shkonte paralel me uljen e lindshmërisë nga viti 1989, në një kontekst social të karakterizuar nga pabarazia gjinore dhe një kulturë që thekson rëndësinë e të pasurit e të paktën një djalë (UNFPA 2012).

Figura 2. Piramidat e popullsisë së Shqipërisë sipas Censurit 2001 dhe 2011



Burimet: Censuri i popullsisë së Shqipërisë 2001 dhe 2011.

Emigrimi i të rinjve, rënia e lindshmërisë, si dhe vdekshmëria më e ulët që nga viti 1989, kanë zvogëluar peshën e brezave të rinj dhe kanë rritur atë të brezave më të vjetër në popullsinë e përgjithshme, duke çuar drejt një moshimi demografik (Tabela 1). Përqindja e personave më pak se 15 vjeç u ul nga 33% në 21% ndërmjet vitit 1989 dhe 2011, ndërsa ajo e personave 65 vjeç e lart u rrit nga 5% në vitin 1989 në 11% në vitin 2011. Pra, në vitin 2011, një fëmijë mbështetej nga tre individë në moshë pune (d.m.th. të moshës 15 deri 64 vjeç), krahasuar me dy në vitin 1989. Nga ana tjetër, ka një të moshuar për çdo gjashtë individë në moshë pune, nga më shumë se tetë në vitin 2001. Shqipëria po përjeton një zëvendësim të varësisë demografike të të rinjve nga ajo e të moshuarve.

Tabela 1. Struktura moshore e popullsisë së Shqipërisë, Censuset 1979-2011, në (%)

Grupmosha	Vitet e Censuseve			
	1979	1989	2001	2011
0-14	37,0	33,1	29,3	20,7
15-64	57,8	61,6	63,2	68,0
65 vjeç e lart	5,3	5,3	7,5	11,3

Burimet: Censuset e Popullsisë së Shqipërisë.


Megjithatë, popullsia e Shqipërisë mbetet ndër popullsitë më të reja në Evropë, me një moshë medianë² prej 32.6 vitesh në vitin 2011 kundrejt asaj të 27 vendeve të Bashkimit Evropian me një mesatare me mbi 41 vjeç (Eurostat). Ndërkaq transformimi i popullsisë drejt plakjes ka implikime ekonomike të mëdha. Kostoja e shoqërisë për mbështetjen e të moshuarve është më e lartë sesa kostoja mesatare e mbështetjes për një fëmijë (ONS UK, 2008). Për rrjedhojë tendencat demografike duhet të monitorohen nga afër.

⁽²⁾ Moshë medianë është moshë në të cilën gjysma e popullsisë është më e re në moshë dhe gjysma tjetër më e madhe në moshë.

LINDSHMËRIA

Numri mesatar i fëmijëve për çdo grua mbeti ndër më të lartit në krahasim me Evropën deri në vitin 2001, edhe pse indeksi sintetik i fekunditetit (ISF; shih Fjalorthin të Shtojcat) pësoi rënie me një ritëm të shpejtë nga 6,8 në vitin 1960 në 2,3 në vitin 2001. Në dekadën e fundit, lindshmëria pësoi rënie nën nivelin e kërkuar për riprodhimin e një çifti (d.m.th. niveli i përgjithshëm i zëvendësimit të gjeneratave: 2,1 fëmijë për çift); ai arriti në 1,7 në vitin 2011, sipas statistikave vitale (Figura 3). Për pasojë, numri i lindjeve në vitin 2011 ishte më pak se gjysma e lindjeve në vitin 1990 (d.m.th. 34.285 lindje në krahasim me 82.125 lindje). Megjithëse vlerësimet e tërthorta të lindshmërisë në bazë të Censuseve 2001 dhe 2011 dhe vrojtimeve me zgjedhje, në mënyrë të vazhdueshme tregojnë nivele të larta dhe konfirmohet një tendencë në rënie. Mospërputhjet ndërmjet burimeve gjithashtu janë ngushtuar në mënyrë të konsiderueshme gjatë viteve, duke dëshmuar për një matje të përmirësuar të lindshmërisë në Shqipëri. Megjithatë, është interesante të theksohet se statistikave vitale sugjerojnë një rikuperim të lehtë të lindshmërisë që nga viti 2008.


Figura 3. Tendencat e indeksit sintetik të fertilitetit (ISF) për Shqipërinë 1980-2012



Burimet: Censuset 2001 dhe 2011, statistikave vitale dhe vrojtime.

Përpara vitit 2001 lindshmëria pësoi rënie në të gjitha grupmoshat, por rënia ishte më e theksuar në moshat 35 vjeç e lart (Figura 4). Deri në 2001 gratë martoheshin në moshë të re (mesatarisht 22,4 vjeç në vitin 2001) dhe përdornin kryesisht metoda tradicionale të kontrollit të lindjeve që synonin më tepër të kufizonin madhësinë e familjes se sa të shtynin lindjen e parë (Falkingham dhe Gjonça 2001; INSTAT et al. 2010). Rënia historike e lindshmërisë në Shqipëri mund të lidhet me përhapjen e arsimit, kufizimet ekonomike për familjet si dhe ndryshimet social kulturore që nxjerrin në pah qëndrime më pak tradicionale në jetën familjare. Niveli i lindshmërisë në të kaluarën ishte më i ulët me të paktën një fëmijë në zonat urbane në krahasim me ato rurale (Dumani 1995). Sipas Censurit të vitit 2011, gratë e moshave nga 45 në 49 vjeç që kishin së shumti një diplomë të ciklit fillor kishin lindur mesatarisht 3,3 fëmijë, kundrejt 1,7 të atyre me të njëjtën moshë dhe me arsim universitar.

Figura 4. Koeficientët specifikë të lindshmërisë (për mijë), Shqipëria 1960-2011



Burimet: Statistikat vitale dhe Censuset e viteve 2001 dhe 2011, Dumani (1995) për periudha më të hershme.

Nga ana tjetër, në vitet 2000, rënia e niveleve të lindshmërisë ishte më e përqendruar tek moshat më të reja, sepse lidhej me një rritje të moshës mesatare në martesën e parë të grave deri në 24 vjeç. Për pasojë, gratë filluan të kishin fëmijë në moshë më të mëdha se sa më parë (d.m.th. lindshmëria shtyhet në kohë; Lerch 2013a). Gratë me arsim më të lartë e filluan përsëri këtë trend. Në vitin 2011, vetëm 16 % e tyre ishin të martuara në moshën 20-24 vjeç, kundrejt 43% të grave me arsim më të ulët. Transformimet e fundit të lindshmërisë në Shqipëri reflektojnë rritjen e nivelit të edukimit, rritjen e mundësive ose vështirësive në tregun e punës, dhe ndoshta, rritjen e rëndësisë së vlerave individuale dhe vetë-realizimit, që siç është parë edhe në Evropën Perëndimore, të gjitha e shtynë në kohë krijimin e familjes. Megjithatë, ndryshimet që reflektojnë këto transformime në vlerat e jetës familjare në të gjithë Evropën nuk janë akoma të konsiderueshme në Shqipëri, sepse vetëm 1,2% e grave në moshën e lindjes së fëmijëve bashkëjetojnë (Dumani dhe Subashi 2011).

Megjithëse Shqipëria duket se ndjek tendencën Evropiane në rënien dhe shtyrjen në kohë të lindshmërisë, moshë mesatare në martesë mbetet e ulët dhe niveli i lindshmërisë i lartë, krahasuar me vendet e tjera në rajon (ISF varion nga 1,3 në Rumani në 2 në Kosovë në vitin 2009; Eurostat; KDHS 2009). Kjo mund të shpjegohet nga fillimi më i vonshëm i tranzicionit të lindshmërisë në Shqipëri, duke nënkuptuar se ka akoma hapësirë për kufizim dhe shtyrje në kohë të lindjeve.

VDEKSHMËRIA


Për shkak të përmirësimeve të mëdha në sistemin shëndetësor dhe në shëndetin publik që nga viti 1950, vdekshmëria në Shqipëri ka pasuar rënie të qëndrueshme për të gjitha moshat. Ndërmjet viteve 1950 dhe 1989, jetëgjatësia në lindje³ u rrit nga 51,9 në 67,9 vjet për burrat dhe nga 51,3 në 73,9 vjet për gratë (Gjonça 2001). Pavarësisht ndryshimeve në zhvillimin social ekonomik me vendet e tjera të Evropës, kushtet shëndetësore të të rriturve ishin të krahasueshme (jetëgjatësia në moshën 25 vjeç ishte 48,3 vjet për burrat dhe 54 vjet për gratë në vitin 1989). Gjonça (2001) sugjeroi se dieta mesdhetare vepronte si një faktor mbrojtës kundër rrezikut të vdekshmërisë.

Vdekshmëria e të rriturve vazhdoi të pësojë rënie deri në vitin 2011, me një jetëgjatësi në moshën 25 vjeç që arrinte 51 vjet për burrat dhe 56 vjet për gratë. Megjithatë, numri i përgjithshëm i vdekjeve u rrit pak nga 18.193 në vitin 1989 në 20.012 në vitin 2011 sepse breza lindjesh të shumtë në numër arrinin në mosha të vjetra, mosha ku vdekshmëria rritet me shpejtësi.

Vdekshmëria foshnjore, nga ana tjetër, ishte ndërmjet më të lartave në Evropë, pavarësisht një rënieje të konsiderueshme që nga viti 1989. Megjithatë, vlerësime të kohëve të fundit ndryshojnë sipas burimeve. Statistikat vitale sugjerojnë se deri në vitin 2011 numri i vdekjeve foshnjore pësoi rënie nga 47 në 9 për çdo një mijë lindje meshkujsh dhe nga 43 në 8 për çdo një mijë lindje femrash (Figura 5). Vlerësimet indirekte nga vrojtimet dhe Censuset e Popullsisë tregojnë të paktën dy herë atë nivel për vitet 2000 (18 vdekje për të dy gjinitë sipas ADHS 2008-09).

Për ndërtimin e tabelës së jetës për vitin 2011, u kombinuan vlerësimet e ADHS për vdekshmërinë e foshnjave dhe fëmijëve me normat e vdekshmërisë në mosha të vjetra bazuar në statistikat vitale (shih Metodën e Shtojcës). Në përputhje me këto vlerësime, jetëgjatësia në lindje vazhdoi të rritej gjatë viteve 1990 me më shumë se katër dhe më pak se pesë vjet respektivisht për meshkujt dhe femrat (Figura 5). Megjithatë, gjatë viteve 2000, progresi ishte më i ulët, por në të njëjtën kohë më i dukshëm tek burrat, në krahasim me gratë: jetëgjatësia u rrit nga 72,9 në 74,5 vjet për burrat ndërmjet viteve 2001 dhe 2011, kundrejt 78,6 dhe 79,3 vjet për gratë. Rrjedhimisht, vdekshmëria tek meshkujt filloi të konvergojë drejt nivelit më të ulët të femrave.

Figura 5. Jetëgjatësia mesatare në lindje (e0) dhe koeficientët specifike të vdekshmërisë sipas gjinisë, 1989, 2001 dhe 2011



Burimet: Gjonça (2001), Statistikat vitale, RHS, DHS, Censuset 2001 dhe 2011.

⁽³⁾ Numri mesatar i viteve që një i sapolindur pritët të jetojë (shih Fjalorthin në Shtojcë)

Rënia e fundit e vdekshmërisë ishte më e theksuar tek fëmijët. Sipas vlerësimeve tona, vdekshmëria foshnjore e meshkujve pësoi rënie nga 26 për mijë në vitin 2001 në 19 në vitin 2011, ndërsa ajo e femrave pësoi rënie nga 20 në 16 për një mijë lindje të gjalla. Pavarësisht këtyre përmirësimeve të mëdha në shëndetin e fëmijëve, Shqipëria vazhdon të ketë ndër nivelet më të larta të vdekshmërisë së fëmijëve në Evropë, ndjekur nga Kosova me 23 vdekje për një mijë lindje (KDHS 2011) dhe afër niveleve të vëzhguara në Maqedoni, Mal të Zi, Bullgari dhe Rumani.

Nëse vdekshmëria u ul gjithashtu edhe tek moshat e vjetra, nivelet e vdekshmërisë u stabilizuan tek femrat dhe u rritën tek meshkujt gjatë viteve 1990. Një tendencë e ngjashme por më e dukshme u pa edhe në vendet e tjera postkomuniste. Në Shqipëri, rritja e vdekshmërisë e lidhur me aksidentet rrugore për shkak të përhapjes së automjeteve si dhe rritja e krimit gjatë viteve 1990 kanë luajtur gjithashtu rolin e tyre, (Gjonça 2006). Megjithatë, vlerësimet e kohëve të fundit tregojnë një rënie të vdekshmërisë në këto moshë.

Sëmundjet e qarkullimit të gjakut mbeten shkaku kryesor i vdekjeve në Shqipëri, me tre deri katër herë më shumë rrezik vdekjeje sesa nga tumoret. Struktura e shkaqeve të vdekjeve në Shqipëri është e ngjashme me atë në Bullgari, Rumani dhe Maqedoni. Kjo është e ndryshme nga vendet e Evropës Perëndimore dhe Jugore ku tumoret janë pothuajse aq të rëndësishëm sa dhe sëmundjet e qarkullimit të gjakut. Rreziku i vdekshmërisë në këto vende ka pësuar rënie për shkak të zhvillimeve në diagnostikimin, terapinë dhe parandalimin e këtyre sëmundjeve (OBSh2010).

MIGRIMI NDËRKOMBËTAR


Vlerësimet e numrit të Shqiptarëve që jetonin jashtë vendit dëshmojnë për shkallën e gjerë të emigrimit. Stoku neto i migrantëve u rrit në 220.000 në vitin 1992 dhe më shumë se 600.000 në vitin 2001 (INSTAT 1999, 2004a). Një diferencë neto e migrimit prej 450.000 u vlerësua për dekadën e fundit (shih Raportin "Migrimi në Shqipëri"). Pra, një mesatare vjetore prej të paktën 50.000 individësh u largua nga Shqipëria gjatë dhjetëvjeçarëve të viteve 1990 dhe 2000 (që përfaqësonte 1,4% të popullsisë së përgjithshme çdo vit). Si në rastin e Moldavisë, emigrimi Shqiptar ishte ndër më të lartët në Evropë.

Megjithëse, ishin meshkujt ata që në fillim dominuan largimin, u vu re një në rritje e numrit të emigrantëve femra sidomos gjatë dekadës së fundit; raporti gjinor i stokut neto të migrimit për moshat 15-39 vjeç pësoi rënie nga më shumë se 5 meshkuj kundrejt 1 femre në vitin 1992 në afërsisht 2 meshkuj kundrejt 1 femre në vitin 2001. Në dekadën e fundit, largimi i meshkujve nuk ndryshoi, por largimi i femrave pësoi një rritje në një shkallë të tillë sa që ato e dominuan migrimin neto (shih Raportin "Migrimi në Shqipëri").

Edhe profili i moshës ndryshoi ndërmjet dy dekadave. Figura 6 tregon koeficientët specifikë vjetorë të emigrimit për secilën gjini, që janë vlerësuar indirekt nga dy Censuse të njëpasnjëshme të popullsisë (emigrantët nuk janë marrë në konsideratë; shihni Metodën e Shtojcës). Gjithashtu tregohet edhe indeksi sintetik i migrimit (ISM): në mënyrë ngjashme me ISF, ky tregues mund të interpretohet si numri i emigrimeve që një individ mund të presë gjatë jetës së tij sipas strukturës aktuale të migrimit. Gjatë viteve 1990, migrimi dominohej nga të rinjtë, megjithëse individë të moshave nga 40 vjeç deri në 60 vjeç ishin gjithashtu pjesë e largimeve – në veçanti gratë. Situatat e atyre viteve mund të kenë detyruar familje të tëra të largohen. Gjatë viteve 2000, emigrimi u bë më shumë selektiv, sepse përfshinte më shumë të rinjtë e grupmoshave 20 deri 30 vjeç – dhe veçanërisht gratë. Pra, faktorë tërheqës jashtë vendit – si p.sh. mundësitë ekonomike, komoditetet sociale dhe pjesëtarët e familjeve të emigruar më parë – mund të kenë luajtur një rol më të madh sesa faktorët shtytës në vendimin e migrimit, në krahasim me vitet 1990.

Në veçanti, rritja e emigrimit të femrave shfaqet e lidhur me ribashkimin e familjes jashtë vendit, megjithëse faktorë të tjerë mund të jenë gjithashtu të rëndësishëm, si studimi apo punësimi. Sipas ADHS në vitet 2008/9, 61% e emigranteve femra u zhvendosën për motive familjare dhe 26% për motive pune, ndryshe nga emigrimi i meshkujve ku dominonin motivet e punësimit; (INSTAT et al. 2010). Sigurisht kjo nuk do të thotë se femrat nuk punojnë jashtë vendit, por që mundësia e tyre për të emigruar është e lidhur me largime të mëparshme të pjesëtarëve të familjeve të tyre në një shkallë më të madhe sesa e meshkujve. Femrat gjithashtu u larguan nga Shqipëria në moshë më të reja sesa meshkujt (mosha të reja që arritën kulmin e shkallës së emigrimit në moshën 22 vjeç përkundrejt meshkujve në moshën 26-27 vjeç). Megjithëse kjo diferencë është e barabartë me ndryshimin tradicional të moshës ndërmjet bashkëshortëve që zhvendosen së bashku, moshë kulmore e emigrimit për femrat është më afër moshës së tyre mesatare të martesës në krahasim me atë të meshkujve, gjë e cila tregon një rritje në migrimet ndërkombëtare për martesë të tyre.


Figura 6. Normat mesatare vjetore të emigrimit sipas gjinisë dhe moshës për Shqipërinë 1989-2001 dhe 2001-2011 (për ‰)



Burimet: Censuset e popullsisë së Shqipërisë 1989, 2001, 2011.

Informacioni për imigrantët ka të bëjë kryesisht me migrimin e kthimit, i cili deri kohët e fundit ishte i ulët. Sipas Censurit të vitit 2011, numri i Shqiptarëve që kishin banuar ndonjëherë jashtë shtetit dhe ishin kthyer u rrit nga 5.000 në vitin 2001 në 36.000 në vitin 2011, e cila mbetet shifër e ulët në krahasim me numrin e të larguarve. Faktorët shpjegues të kësaj rritjeje janë të paqartë. Megjithatë mund të përmendim pasojat e krizave Italiane dhe Greke. Gjithsesi vetëm rreth 15% e Shqiptarëve që jetonin në Greqi në vitin 2012 planifikonin të ktheheshin që nga fillimi i krizës (Gëdeshi dhe De Zwager 2012). Krahas kësaj, numri në rritje i kalimit të kufirit nga Greqia (fluksi në periudhën 2008-2012 përfaqësonte një të pestën e popullsisë Shqiptare në atë vend; ACIT dhe USAID 2012), mund të ketë zgjeruar grupin e kandidatëve të rinj për emigrim. Shumica e të kthyerve përbëhej nga meshkuj të grupmoshave 20 deri 39 vjeç (Figura7).

Figura 7. Të kthyerit në Shqipëri në vitin 2011 sipas grupmoshës dhe gjinisë



Burimet : Censusi 2011.

Gratë morën pjesë në mënyrë të kufizuar në migrimin e kthimit. Kjo nuk është një gjë e papritur sepse jashtë vendit banorin më shumë burra sesa gra dhe se veçanërisht migrimi i meshkujve në moshë të reja karakterizohet nga disa udhëtime të shkurtra jashtë vendit. Figura 7 sugjeron se femrat e kthyer zakonisht janë bashkë me fëmijët e tyre, ndryshe nga kthimet e pavarura më të shpeshta të burrave. Kriza aktuale në Greqi dhe Itali mund t'i motivojë pjesëtarët e varur të familjes të kthehen në një përpjekje për lehtësimin e kostove të jetesës për migrantët jashtë vendit.

NDRYSHIMET DEMOGRAFIKE NË QARQET E SHQIPËRISË

Një analizë e detajuar e tendencave demografike në nivel qarku gjendet te Shtojcat. Këtu, rezultatet kryesore jepen në mënyrë të përmbledhur. Rënia demografike përfshinte të gjitha qarqet, përveç Durrësit dhe Tiranës sepse këto qarqe patën një emigrim të ulët dhe thithën shumicën e migrantëve të brendshëm. Njësoj si në vitet 1990, shpopullimi ishte më i fortë në qarqet periferike në Jug dhe në Veri edhe gjatë viteve 2000 (veçanërisht në Gjirokastrë, Berat, Kukës, dhe Dibër).

Plakja e popullsisë është më e theksuar në Jug (Gjirokastrë, Korçë, Vlorë, Berat), sepse rajoni filloi rënien historike të lindshmërisë dhe kishte shkallën më të madhe të emigrimit që nga vitet 1990. Këto qarqe kaluan me shpejtësi nga një dominim i moshave të reja tek ai i moshave të vjetra, siç vërehet në Evropën Perëndimore që nga viti 2005 si dhe kohët e fundit në Kroaci, Slloveni dhe Bosnje Hercegovinë.

Rënia e nivelit të vdekshmërisë u vërejt në të gjithë Shqipërinë kështu që gjeografia e vdekshmërisë nuk ndryshoi në krahasim me periudhat e kaluara. Një konvergencë rajonale drejt niveleve të ulta të lindshmërisë u vërejt gjatë viteve 1990 (Lerch et al. 2010), dhe vazhdoi edhe gjatë viteve 2000. Në vitin 2011, ISF ishte më i ulët se niveli i kërkuar për zëvendësimin e brezave aktualë në të ardhmen (d.m.th nën 2,1) në të gjitha qarqet.

Shanset për emigrim jashtë shtetit u mundësuan gjithashtu në të gjithë Shqipërinë në vitet 2000, duke përfshirë edhe qarqet veriore. Largimet jashtë vendit dominuan qartësisht migrimin e brendshëm në të gjitha qarqet, përveç Kukësit dhe Dibrës, ku të dy tipet ishin njësoj të rëndësishëm. Strukturat e grupmoshave për emigrim ishin të ngjashme dhe pati një pjesëmarrje të barabartë të meshkujve dhe femrave në të gjitha qarqet. Nivelet e emigrimit brenda vendit konverguan gjithashtu ndërmjet qarqeve (duke përfshirë një rritje në Jug). Migrantët në vitet 2000 ishin kryesisht femra të reja rreth moshës 20 vjeç. Si dhe në rastin e migrimit ndërkombëtar, por në një shkallë më të gjerë, migrimi i brendshëm gjithnjë e më shumë lidhet me tranzicionet e mëdha gjatë jetës, si p.sh. gjetja e një pune, arsimimi në një nivel më të lartë, ose martesë (veçanërisht për gratë). Pra, migrimi Shqiptar në të gjitha qarqet u transformua nga një fenomen i përkohshëm dhe i nxitur nga krizat, në një sjellje më të përhershme në kërkim të mundësive, e lidhur me planet për jetën familjare ose martesën.

Imigrimi ndërkombëtar (që përfaqëson kryesisht kthime të emigrantëve) mbeti i përqendruar në zonat më urbane, veçanërisht në ato të ndodhura në bregdet. Migrantët e brendshëm gjithashtu u zhvendosën veçanërisht në qarqet e Tiranës dhe Durrësit. Këto tendenca të kombinuara me emigrimin nga zonat periferike, e rritën shumë nivelin e urbanizimit në Shqipëri (nga 36% në vitin 1989 në më shumë se 50% në vitin 2011) dhe theksuan përqendrimin e popullsisë në qarqet e Durrësit dhe Tiranës, ku jetonin 36% e banorëve në vitin 2011 përkundërt 22% në vitin 1989.

3

Metodologjia dhe Hipotezat



METODOLOGJIA E PROJEKSIONEVE

Ndryshimi demografik ndodh kur çiftet linden fëmijë dhe kur individët arrijnë nga vende të tjera duke shtuar anëtarë të rinj në popullsi, ndërsa të tjerë vdesin apo largohen në vende të tjera, duke e zvogëluar popullsinë. Për shkak se këto ngjarje demografike ndikojnë tek popullsia sipas gjinisë dhe grupmoshave të ndryshme, ato përcaktojnë numrin dhe strukturën e saj. Objektivi kryesor i projeksioneve demografike është përcaktimi se si lindjet, vdekjet dhe migrimet do të ndodhin në vitin pasues. Metodologjia e përdorur për këtë cikël të tretë të projeksioneve të popullsisë nga INSTAT-i, modeli i komponentit të brezave, përllogarit këto ngjarje për secilin vit, gjini apo moshë sipas supozimeve të tendencave të besueshme të vdekshmërisë, lindshmërisë dhe migrimit në të ardhmen. Këto ngjarje i zbriten dhe i shtohen popullsisë në fillim të vitit, duke dhënë popullsinë sipas moshës dhe gjinisë në fillim të vitit pasues, e kështu me radhë.

Numri i ngjarjeve demografike varet nga struktura e popullsisë edhe nga sjellja demografike (d.m.th numri i lindjeve varet nga numri i grave në moshën riprodhuese dhe koeficientët specifikë të lindshmërisë). Meqenëse struktura e popullsisë dhe sjelljet demografike njihen për vitin bazë (respektivisht nga Censusi i vitit 2011 dhe analiza të mëparshme), tendencat e ardhshme në sjelljen demografike u parashikuan bazuar në hipotezat që mbështeten në njohuritë tona të situatës demografike, tendencat e kaluara, konteksti politik dhe social ekonomik, dhe krahasimet ndërkombëtare (shih seksionin tjetër).

Popullsia sipas grupmoshës dhe gjinisë në fillim të projeksioneve, 1 Janar 2011, është vlerësuar nga INSTAT nëpërmjet retropolimit të popullsisë së regjistruar në 1 Tetor 2011 (duke marrë në konsideratë emigrimin dhe imigrimin e kohëve të fundit si dhe shkallë nën-regjistrimit).

Popullsia në nivel kombëtar, sipas gjinisë dhe moshës projektohet në mënyrë të përsëritur vit pas viti, duke filluar me popullsinë në 1 Janar, si më poshtë:

- Numri i vdekjeve vlerësohet për gjashtë muajt e parë nga aplikimi i normave të vdekshmërisë sipas moshës dhe gjinisë për popullsinë në 1 Janar; vdekjet zbriten nga popullsia për të përfutur të mbijetuarit në mes të vitit (30 Qershor);
- Numri i emigrantëve sipas grupmoshës dhe gjinisë vlerësohet nga popullsia në mes të vitit duke përdorur normat e migrimit dhe këto ngjarje më pas zbriten; ndërkohë numri i supozuar i imigrantëve sipas gjinisë rishpërndahet sipas moshës dhe i shtohet popullsisë.
- Numri i vdekjeve për semestrin e dytë më pas vlerësohet dhe zbritet nga ky numër i rishikuar i popullsisë në mes të vitit, duke dhënë numrin e të mbijetuarve në 31 Dhjetor;
- Numri i lindjeve vlerësohet duke shumëzuar normat e lindshmërisë sipas grupmoshave me numrin mesatar të femrave në moshë riprodhimi; vdekjet e foshnjave dhe ato që emigrojnë deri në fund të vitit vlerësohen dhe zbriten nga numri i lindjeve;
- Për të projektuar popullsinë në 1 Janar të vitit pasues, secili grup çohet përpara me një vit në moshë, për të reflektuar plakjen e popullsisë dhe numri i lindjeve mbijetuese brenda vendit përbën moshën e parë (mosha 0).

Popullsia e qarqeve sipas gjinisë dhe grupmoshave 5 vjeçare projektohet në mënyrë të përsëritur dhe njëkohësisht në intervale pesë vjeçare duke përdorur një model shumërajonal të rezervës së migrimit të komponentit të brezave, i cili u përshtat nga modeli shumë rajonal i propozuar nga Kombet e Bashkuara (OKB, Kombet e Bashkuara 1992). Procedura përmban hapat e mëposhtëm për secilin qark:

- Popullsia sipas gjinisë dhe moshës në fillim të intervalit projektohet të mbijetojë me 5 vjet.
- Emigrantët mbijetues (jashtë vendit) dhe emigrantët brenda vendit (në qarqe të tjera) vlerësohen njëri pas tjetrit duke përdorur normat e tranzicionit për migrantët (pasi është marrë parasysh vdekshmëria dhe migrimin ndërkombëtar në rastin e emigrimit brenda vendit), që zbatohen për popullsinë në fund të intervalit. Emigrantët i zbriten numrit të popullsisë dhe emigrantët brenda vendit shpërndahen sipas grupmoshës dhe gjinisë, duke dhënë numrin e imigrantëve brenda vendit për rishpërndarje.
- Numri i imigrantëve brenda vendit, si dhe një numër i supozuar i imigrantëve (nga parashikimi në nivel kombëtar) i shtohen popullsisë në fund. Këto individë rishpërndahen sipas qarqeve në përputhje me shpërndarjen e tyre respektive gjeografike (sipas grupmoshës dhe gjinisë) në vitet 2006-2011.
- Lindjet vlerësohen duke i aplikuar normat specifike të lindshmërisë popullsisë mesatare në fillim dhe në fund të intervalit 5 vjeçar dhe projektohen të mbijetuarit deri në fund të intervalit.
- Për të përfutur popullsinë në 1 Janar në fillim të intervalit pasues 5 vjeçar, secili brez çohet përpara me pesë vjet në moshë për të reflektuar plakjen e popullsisë; numri i lindjeve të gjalla brenda Shqipërisë përbën grupmoshën e parë.
- Popullsia sipas gjinisë dhe moshës dhe ngjarjet demografike në nivel qarku duhet që të përkohet me totalin e përcaktuar nga projeksionet kombëtare.

HIPOTEZAT PËR LINDSHMËRINË, VDEKSHMËRINË DHE MIGRIMIN NË TË ARDHMEN

Për dhënien e një sërë tendencash të besueshme për të ardhmen e popullsisë në Shqipëri dhe për të paraqitur pasigurinë e projeksioneve u ndërtuan hipoteza të ndryshme në lidhje me vdekshmërinë, lindshmërinë dhe migrimin.

Hipotezat e lindshmërisë

Rritja e fundit në ISF e evidentuar nga statistikat vitale, i shton pasiguri zhvillimeve të ardhshme në lindshmëri. Nga njëra anë mund të përfaqësojë një luhatje afatshkurtër – siç është vëzhguar në të kaluarën në Shqipëri dhe në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Lindshmëria në fakt përcaktohet nga ndikime sociale konkurruese – duke përfshirë një ndryshim strukturor në tregun e punës, rritja e niveleve të arsimit, ndryshimi i vlerave, por gjithashtu edhe nga ndikimet e institucioneve tradicionale sociale të tilla si familja e zgjeruar dhe kultura patriarkale – që mund të çojnë drejt trendeve të çrregullta të rënies. Nga ana tjetër, rritja e fundit mund të jetë gjithashtu pararendëse e një rikuperimi të zgjatur siç është rasti i Mongolisë – megjithëse tendenca në rritje atje u motivua nga zbatimi i një politike familjare proaktive, gjë që nuk është rasti i Shqipërisë. Për të reflektuar këtë pasiguri në projeksione, u përcaktuan tre hipoteza të tendencës së ardhshme të lindshmërisë. Megjithëse të gjitha hipotezat supozojnë se gratë do të lindin në mosha më të mëdha në të ardhmen (d.m.th shtyrje e lindjeve në kohë), ato kryesisht ndryshojnë në përputhje me trendin e numrit mesatar të lindjeve për grua (ISF).

Hipoteza e lindshmërisë së ulët bazohet në tendencën afatgjatë dhe sugjeron një konvergjencë të vazhdueshme në drejtim të modelit Evropian. Pritet një rënie e ngjashme ashtu si dhe në ciklin e kaluar të projeksioneve (INSTAT 2004), i cili pati një parashikim mjaft të mirë për nivelin e lindshmërisë për vitin 2011. ISF do të zbrësë nga 1,73 në vitin 2011 në 1,3 fëmijë për grua në vitin 2026 (Tabela2). Një ritëm i ngjashëm u vëzhgua në Portugali dhe në Maqedoni në të kaluarën.

Pas një vlere minimale të ISF-së në vitin 2026, pritet një rritje e lehtë deri në nivelin 1,4 për shkak të lindjeve në moshë të madhe, të cilat më parë ndodhnin tek moshat më të reja. Shumë vende të Evropës Perëndimore, Qendrore dhe Lindore kanë kaluar një rritje të tillë në lindshmëri që nga viti 2003 (Eurostat 2013). Në përputhje me shtyrjen e lindjeve të pritshme dhe rikuperimin pasues, ne parashikojmë një plakje në lindshmëri (si dhe një përqendrim fillestar, pasuar nga një spostim i normave specifike të lindshmërisë rreth moshës mesatare në lindje).

Kjo konvergjencë e Shqipërisë drejt modelit dominues të lindjes së fëmijëve në Evropë mund të pritët përgjatë procesit të vazhdueshëm të modernizimit të shoqërisë. Supozohet që lindshmëria e lartë e zonave rurale do të shkojë drejt niveleve të zonave urbane (ISF-të respektive ishin 1,9 dhe 1,3 në vitin 2007, sipas ADHS), si dhe adoptimi i standardit urban të lindjes së fëmijëve nga migruesit nga zonat rurale në ato urbane. Kjo hipotezë e ulët nënkupton një rritje të vazhdueshme në arsimimin e nivelit të lartë, dhe një pjesëmarrje më të lartë të grave në tregun e punës, gjë e cila e komplikon pajtimin e madhësisë ideale të familjes me përgjegjësitë profesionale.

Efektet e krizës potenciale ekonomike do të mbështesnin gjithashtu shtyrjen dhe rënien e lindshmërisë, siç vëzhgohet në Evropë (Goldstein 2013). Përtej efekteve negative të të ardhurave, lidhjet e forta familjare i motivojnë çiftet e reja për t'u kujdesur për situatën financiare dhe shëndetësore të prindërve të tyre, gjë e cila mund të çojë drejt një lindshmërie të shtyrë dhe të kufizuar tek brezi i ri. Krahas kësaj, emigrimi i djemve të rinj çon në martesë të vonshme dhe/ose ndarje bashkëshortësh, gjë e cila mund t'i vonojë lindjet. Kthimi i mundshëm i më shumë emigrantëve pas vitit 2026 mund të shoqërohet gjithashtu me rikuperimin e lindshmërisë kur çiftet ribashkohen në Shqipëri (Dumani dhe Subashi 2011).

Tabela 2. Hipotezat e lindshmërisë së lartë, të mesme dhe të ulët në Shqipëri për vitet 2011-2031

	2011	2021	2026	2031	2060
ISF					
E ulët	1,73	1,44	1,30	1,40	
E mesme	1,73	1,61	1,56	1,50	1,50
E lartë	1,73	1,91	2,00	2,10	
Ndryshimi vjetor në moshën mesatare në lindje (në vite)					
E ulët	0,05	0,05	0,20	0,20	
E mesme	0,05	0,03	0,03	0,03	0,00
E lartë	0,05	0,05	0,05	0,05	
Ndryshimi vjetor në variancën e moshës në lindje					
E ulët	-0,30	-0,30	0,20	0,20	
E mesme	0,00	-0,20	-0,20	-0,20	0,00
E lartë	0,05	0,05	0,05	0,05	

Hipoteza e mesme e lindshmërisë merr në konsideratë tendencën e fundit që nga viti 2008, pasqyruar nga statistikat vitale. Rritja e evidentuar konsiderohet si pjesë e një tendence luhatëse rreth një rënije më pak të pjerrët sesa në hipotezën e ulët: një ISF 1,61 pritët për vitin 2021 dhe 1,5 në vitin 2031. Për shkak të shtyrjeve të vazhdueshme të lindjeve, i gjithë skeduli i koeficientëve specifike të lindshmërisë shtyhet për tek moshat më të larta.

Hipoteza e lindshmërisë së lartë, interpreton tendencën në rritje të viteve të fundit si një prelude i një rikuperimi afatgjatë. ISF-ja pritët të arrijë nivelin e zëvendësimit të gjeneratave (2,1) në vitin 2031, i cili në fakt korrespondon me nivelin aktual të lindshmërisë së brezit. Kjo hipotezë supozon se forca të ndryshme sociale në Shqipëri do ta ngadalësojnë përhapjen sociale të modeleve evropiane të lindjes së fëmijëve. Kultura patriarkale dhe pabarazia gjinore mbeten komponentë të rëndësishëm dhe vazhdojnë të nxisin pasjen e familjeve të mëdha nëpërmjet ndikimeve sociale për sjelljen riprodhuese të vajzave (Lerch 2013b). Ky mund të jetë rasti veçanërisht me zonat rurale, ku gjyshërit dhe pjesëtarët e familjes jetojnë me ose pranë brezit më të ri, duke mbështetur lindjen dhe rritjen e fëmijëve. Krahas kësaj, lindshmëria ishte gjithashtu më e lartë në qytetet me shumicë imigrantësh të brendshëm, ku shpesh rikrijohet socializimi rural (Lerch 2013c). Pra adaptimi me standardet riprodhuese urbane mund të zgjasë më shumë sesa një brez. Paratë e dërguara nga emigrantët gjithashtu u mundësojnë çifteve të kenë më shumë fëmijë dhe kështu të realizojnë idealet e tyre në lidhje me madhësinë e familjes. Sipas ADHS 2008-9, numri ideal i fëmijëve ishte ende 2,6 fëmijë dhe vetëm një e pesta e grave me një fëmijë kishte për qëllim të ndërpriste lindjet (INSTAT et al. 2010).

Koeficientët specifike të lindshmërisë janë modeluar duke përdorur një funksion gama të përcaktuar nga tre parametra, për të cilët janë parashikuar tendencat në përputhje me hipotezat më lart: shkalla (ISF), koha (mosha mesatare në lindjen e fëmijës), dhe përqendrimi i lindshmërisë sipas moshës (varianca e moshës në lindje).

Raporti gjinor në lindje pritët të barazohet me nivelin biologjik në të ardhmen, duke filluar nga 110 lindje meshkujsh kundrejt 100 lindjeve të femrave në vitin 2011.

Hipotezat e vdekshmërisë

Koeficientët specifikë të vdekshmërisë sipas grupmoshës dhe gjinisë janë projektuar duke u nisur nga nivelet e vrojtuar në vitin 2011 dhe duke përdorur një shkallë fikse përmirësimi bazuar në tendencat e 10 viteve të fundit si në Shqipëri ashtu edhe në përvojat e vendeve fqinje (Maqedonia dhe Italia). Parashikohet një rënie më e ngadaltë në vdekshmërinë e moshave më të mëdha sesa te fëmijët, pasi niveli është tashmë i ulët. Rënia mund të nxitet nga një stil jetese më i shëndetshëm (duke përfshirë konsumim më të vogël të duhanit dhe alkoolit dhe më pak aksidente), si dhe me zhvillime në teknologjinë mjekësore (dhe bio-teknologjinë), të cilat mund ta reduktojnë vdekshmërinë nga sëmundjet kardiovaskulare. Rritja e efektivitetit të sistemit për kujdesin shëndetësor dhe përhapja më e mirë e informacionit tek popullsia si dhe tek institucionet, e mbështet këtë tendencë. Tendencat aktuale e konvergjencës së vdekshmërisë së meshkujve me nivelet e ulta të saj tek gratë pritët të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Hipoteza e ulët supozon shkallën vjetore të mëposhtme të rënies së vdekshmërisë të femrat: 7% për foshnjat, 5% për fëmijët e moshës 1 deri 4 vjeç, 4,3% për grupmoshat 5 deri 59 vjeç, dhe 1% për grupmoshat e vjetra. *Hipoteza e vdekshmërisë mesatare* jep një ulje vjetore me respektivisht 5%, 2%, 1,5% dhe 1%. Përqindjet korresponduese të ndryshimit, të marra

nga hipoteza e vdekshmërisë së lartë janë 3,5%, 2%, 1,2% dhe 1%. Këto nivele të rënies së koeficientëve të vdekshmërisë shtohen me 0,5 pikë përqindje për meshkujt për të parashikuar një konvergjencë vdekshmërie ndërmjet gjinive.

Pra, hipoteza e ulët nënkupton se vdekshmëria foshnjore dhe e fëmijëve do të përgjysmohet gjatë secilës prej periudhave 2011-2021 dhe 2021-2031, duke rezultuar në një vdekshmëri finale me një të katërtën e nivelit të vitit 2011 (Tabela 3). Hipoteza mesatare jep një konvergjencë me nivelin e vdekshmërisë së foshnjave të vrojtuar në Itali rreth viteve 2000, ndërsa hipoteza e lartë nënkupton një konvergjencë me standardet italiane në vitin 1996. Në zgjerimin e hipotezës mesatare për periudhën 2031-2060, normat vjetore të rënies së vdekshmërisë mbi moshën 4 vjeç janë mbajtur konstante, ndërsa vdekshmëria tek fëmijët mbetet e pandryshuar.

Tabela 3. Hipotezat e vdekshmërisë foshnjore të ulët, të mesme dhe të lartë (për 1.000 lindje të gjalla) për periudhën 2011-2031

	E Ulët			E Mesme			E Lartë		
	2011	2021	2031	2011	2021	2031	2011	2021	2031
Meshkuj	15,9	7,1	3,2	15,9	9,0	5,1	15,9	10,1	6,4
Femra	12,9	6,1	2,9	12,9	7,7	4,9	12,9	8,9	6,2

Sipas këtyre supozimeve, jetëgjatësia për meshkujt varion ndërmjet nivelit më të lartë me 79,3 vite tek ai i ulët me 77,4 vite në vitin 2031, dhe me një parashikim të mesëm prej 78 vitesh (Tabela 4). Jetëgjatësia e femrave varion nga 81,5 në 83 vite, me një parashikim të mesëm prej 81,9 vitesh.

Tabela 4. Jetëgjatësia në lindje sipas hipotezave për vdekshmërinë e ulët, të mesme dhe të lartë

Viti	E Ulët		E Mesme		E Lartë	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
2011	74,4	79,2	74,4	79,2	74,4	79,2
2021	77,2	81,4	76,6	80,8	76,2	80,7
2031	79,3	83,0	78,1	81,9	77,4	81,5
2061			81,1	84,1		

Hipotezat për migrimin ndërkombëtar

Duke pasur parasysh dy dekadat e mëparshme të emigrimit në shkallë të gjerë, të përhapur në të gjithë Shqipërinë, të gjitha hipotezat supozojnë një tendencë përgjithësisht në ulje për njëzet vitet e ardhshme. Në disa vende që kanë provuar emigrime të shumta (si p.sh. Koreja e Jugut, Meksika ose Maroku), flukset barazohen pas të paktën 15 deri 20 vitesh (De Haas 2007). Shumë zona periferike tashmë provuan një shpopullim të fortë dhe nxitja e emigrimit pritet të reduktohet në të ardhmen. Në të njëjtën kohë, emigrimi për arsye pune në Itali dhe Greqi u ul, pasi emigrimi shqiptar u transformua nga një emigrim i dominuar nga meshkujt në një emigrim familjar ose martesor, ndërkaq edhe arsimimi luan një rol të rëndësishëm. Duke pasur parasysh nivelet e emigrimit për të dy gjinitë gjatë dekadës së fundit, janë supozuar tendenca të ngjashme në të ardhmen si për meshkujt ashtu dhe për femrat.

Prurjet e imigrimit përbëhen kryesisht nga migrantë që kthehen. Numri i tyre kohët e fundit është rritur edhe për shkak të krizës në Greqi dhe Itali, por pritet të reduktohet më vonë me daljen nga kriza. Megjithatë Shqipëria mund të bëhet tërheqëse për emigrantët jashtë vendit, siç supozohet në hipotezat e mëposhtme. Shkalla e kësaj tërheqjeje supozohet të varet nga ritmi i rritjes ekonomike në Shqipëri. Emigrantët do të fillojnë gjithashtu të arrijnë moshën e pensionit dhe, ndoshta, të kthehen gjithnjë e më shumë në fund të viteve 2020. Të gjitha supozimet japin një emigrim më të lartë sesa imigrimi, kështu që migracioni neto do të mbetet negativ, por supozimet ndryshojnë kryesisht tek ritmi i rënies së emigrimit.

Sipas hipotezës së migrimit të ulët, koeficientët e vrojtuar gjatë viteve 2000 parashikohen të ulen me një ritëm më të lartë: me dy të tretat deri në vitin 2021 (duke dhënë një Indeks Sintetik të Migrimit (ISM) 0,5 si për burrat edhe për gratë; Tabela 5). Mendohet se deri në vitin 2021 Shqipëria mund të jetë anëtarësuar në Bashkimin Evropian, gjë e cila do të lehtësonte lëvizjen ndërkombëtare, kështu që ISM pritet të mbetet konstant pas këtij viti. Numri i imigrantëve pritet të reduktohet nga 24 në 8 mijë për meshkujt ndërmjet viteve 2011 dhe 2021, dhe nga 12 në 6 mijë për femrat. Këto shifra mendohet të mbeten konstante deri në vitin 2031.

Tabela 5. Hipoteza e ulët e migrimit ndërkombëtar (indeksi sintetik i emigrimit dhe numri i imigrantëve), 2011-2031

	2011	2021	2031
Emigrimi (ISM)			
Meshkuj	1,5	0,5	0,5
Femra	1,5	0,5	0,5
Imigrimi (N)	36.408	14.000	14.000
Meshkuj	24.145	8.000	8.000
Femra	12.263	6.000	6.000

Kjo hipotezë e ulët bazohet tek pritshmëritë për tendencat pozitive të ekonomisë shqiptare, e cila mund të vazhdojë të evitojë recesionin. Rritja e investimeve të huaja direkte dhe mobilizimi më i mirë i burimeve ekonomike, financiare dhe të punës duhet të çojë drejt mundësive më të mëdha për punësim. Duke pasur parasysh një reduktim të pritshëm në hendekun e pagave ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të Evropës Perëndimore, elementët tërheqës jashtë vendit mendohet të pakësohen, gjë e cila do të mbështeste lëvizjet e kthimit. Destinacionet e brendshme të tilla si ekonomitë urbane në rritje do të bëhen një alternativë tërheqëse për njerëzit që banojnë në periferi.

Një politikë më kufizuese migrimi në Greqi dhe Itali mund t'i reduktojë edhe më shumë mundësitë për një (ri-)imigrim të ligjshëm. Për rrjedhojë, emigrantët që jetojnë tashmë jashtë vendit mund të qëndrojnë atje për periudha edhe më të gjata, duke çuar në një stabilizim të numrit të të kthyerve. Pra, struktura tipike vajtje-ardhje e migrimit Shqiptar pritet të mbarojë.

Hipoteza e migrimit të mesëm parashikon të ketë një rënie më të vogël të intensitetit të emigrimit, për të arritur në vitin 2021 në gjysmën e nivelit të vrojtuar në vitet 2000 (d.m.th një ISM prej 0,7; Tabela 6). Një rënie më e ngadaltë parashikohet të ndodhë deri në vitin 2031 për të arritur nivel të njëjtë me atë të supozuar në hipotezën e migrimit të ulët (d.m.th një e treta e nivelit në vitet 2000). Numri i pritshëm i imigrantëve supozohet të ulet në 6.000 meshkuj dhe në 4.000 femra në vitin 2021, dhe më pas të mbetet i pandryshueshëm. Projektioni deri në vitin 2060 supozon koeficientë emigrimi dhe numër imigrantësh të pandryshueshëm.

Tabela 6. Hipoteza e mesme e migrimit ndërkombëtar (indeksi sintetik i emigrimit dhe numri i imigrantëve), 2011-2060

	2011	2021	2031	2060
Emigrimi (ISM)				
Meshkuj	1,5	0,7	0,5	0,5
Femra	1,5	0,7	0,5	0,5
Imigrimi (N)	36.408	10.000	10.000	10.000
Meshkuj	24.145	6.000	6.000	6.000
Femra	12.263	4.000	4.000	4.000

Një rënie kaq e vogël në emigrim dhe ulje e menjëhershme në imigrim nënkupton një sjellje të re të migrantëve ndaj vendeve fqinje në kontekstin e rikuperimit të tyre ekonomik. Nga ana tjetër, migrantët mund të drejtohen drejt destinacioneve të reja në distanca më të largëta gjeografike nga Shqipëria – drejt Britanisë së Madhe dhe Gjermanisë (shih "Migracioni në Shqipëri"). Krahës kësaj, familjet vazhdojnë të bashkohen jashtë shtetit, veçanërisht kur politikatat e imigrimit e kufizojnë migrimin për arsye pune dhe i komplikojnë lëvizjet vajtje-ardhje. Niveli më i lartë i emigrimit në një kohë të shkurtër mbështetet gjithashtu nga një dëshirë në rritje e të rinjve për të studiuar jashtë vendit.

Hipoteza e migrimit të lartë është më në përputhje me zhvillimet e kohëve të fundit të emigrimit në shkallë të gjerë, pasi pritet të ketë një tendencë në zbritje. Ajo parashikon një rënie lineare në intensitetin e emigrimit, gati sa gjysma deri në vitin 2031 (duke dhënë një ISM 0,8; Tabela 7). Numri i imigrantëve parashikohet të bjerë në një shkallë më të gjerë deri në vitin 2021 në krahasim me hipotezat e tjera – në 5.000 meshkuj dhe 3.000 femra – dhe më pas të mbetet konstant.

Ky supozim jep një rikuperim relativisht të shpejtë nga krizat e Greqisë dhe Italisë së bashku me diversifikimin e destinacioneve të migrantëve, si dhe një zhvillim më të ndadaltë të ekonomisë shqiptare duke nënkuptuar një konvergjencë të ulët në nivelet e pagave me Evropën Perëndimore. Një nivel i lartë i papunësisë së të rinjve mund të vazhdojë të motivojë largimet e brezave të rinj.

Tabela 7. Hipoteza e lartë e migrimit ndërkombëtar (indeksi sintetik i emigrimit dhe numri i imigrantëve), 2011-2031

	2011	2021	2031
Emigrimi (ISM)			
Meshkuj	1,5	1,1	0,8
Femra	1,5	1,1	0,8
Imigrimi (N)	36.408	8.000	8.000
Meshkuj	24.145	5.000	5.000
Femra	12.263	3.000	3.000

Raportet ndërmjet koeficientëve specifikë të emigracionit sipas gjinisë dhe grupmoshave të vëzhguara në vitet 2000 janë ruajtur edhe për hipotezat e mësipërme të ISM-së, duke supozuar një strukturë të pandryshuar për moshën. Shpërndarja relative sipas grupmoshës të imigrantëve meshkuj dhe femra është gjithashtu konstante sipas modelit të vëzhguar në vitin 2011.

Hipotezat për migrimin e brendshëm

Supozimet e migrimit ndërmjet qarqeve përcaktojnë tendencën e niveleve të emigrimit brenda vendit dhe shpërndarjen relative gjeografike të migrantëve sipas qarqeve.

Hipoteza e ulët e migrimit të brendshëm parashikon një nivel konstant në periudhën 2011-2016 (d.m.th. e barabartë me ISM-në e periudhës 2007-11), ndjekur nga një rënie në të gjitha qarqet me gjysmën e atij niveli deri në vitin 2031. Duke pasur parasysh 20 vitet e fundit të karakterizuara nga një arritje e fortë e nivelit të urbanizimit, në të ardhmen mund të pritet një ngadalësim i këtij procesit.

Hipoteza e mesme e migrimit të brendshëm, parashikon se përqindjet e emigrimit brenda vendit në qarqe për periudhën 2007-2011 janë mbajtur konstante gjatë gjithë periudhës së projeksionit. Ajo është e bazuar në perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studentëve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve, si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re. Në të gjitha qarqet (përveç Dibrës, Kukësit dhe Gjirokastrës) kjo nënkupton një përqindje të vazhdueshme të ulët të migrimit të brendshëm kur krahasohet me rënien e supozuar të emigrimit ndërkombëtar.

Hipoteza e lartë e migrimit të brendshëm bazohet në idenë e zëvendësueshmërisë së migrimit të brendshëm me atë ndërkombëtar. Megjithatë migrimet ndërkombëtare kanë qenë më të mëdha se lëvizjet e brendshme në të kaluarën e tyre, mund të thuhet se rënia ndodh paralelisht me një rritje në lëvizjet e brendshme. ISM-ja e emigrimit brenda vendit pritet të rritet me gjysmën e numrit deri në vitin 2031, krahasuar me nivelin e periudhës 2007-2011. Zhvillimi i vazhdueshëm ekonomik pritet të rrisë tërheqjen drejt qyteteve, të cilat do të thithin emigrantët e mundshëm. Migrimi i brendshëm pritet të dominojë emigrimin nga viti 2021 e tutje për femrat dhe 2026 e tutje për meshkujt (përveç Dibrës dhe Kukësit, ku migrimi i brendshëm është dominues gjatë gjithë periudhës së projeksionit).

Në *hipotezën e përqendrimit territorial të migrimit të brendshëm*, është supozuar një rishpërndarje konstante e grupit të migrantëve të brendshëm sipas qarqeve (sipas gjinisë dhe grupmoshës), siç vërehet gjatë 20 viteve të fundit. Ky supozim nënkupton një gjeografi ekonomike të pabalancuar të Shqipërisë në të ardhmen, me Tiranën dhe Durrësin si qendrat kryesore të aktiviteteve.

Hipoteza e shpërqendrimit territorial të migrimit të brendshëm parashikon një shpërndarje më të barabartë të imigrantëve brenda vendit për arsye të ndryshme. Sistemi arsimor mund të decentralizohet duke rritur frekuentimin e universiteteve

dhe shkollave private të vendosura jashtë Tiranës dhe Durrësit, veçanërisht në Elbasan, Vlorë dhe Shkodër. Duke përfutur nga kostot e ulta të strehimit, migrantët në Tiranë mund të vendosen gjithnjë e më shumë në Elbasan dhe të udhëtojnë vajtje-ardhje. Supozimi i decentralizimit të migrimit është gjithashtu i justifikuar nga mundësitë në rritje të punësimit në sektorin e turizmit përgjatë bregdetit, si dhe nga prioriteti politik i synuar që i jepet zhvillimit ekonomik rajonal, si p.sh. mbështetje ndaj industrisë në sektorin bujqësor. Ka tashmë dëshmi që tregojnë shfaqjen e një migrimi të përkohshëm për punë nga Veriu në Jug në sektorin bujqësor (veçanërisht në Sarandë). Joshja për lëvizje nga qarqet e tjera drejt Jugut mund të rritet në të ardhmen nëse do të realizohet projekti i një rruge të re që lidh Tiranën-Elbasanin-Beratin-Gjirokastrën. Së fundmi, hipoteza e një shpërqendrimi territorial të migrimit të brendshëm justifikohet nga procesi aktual i decentralizimit administrativ dhe fiskal në Shqipëri.

Këto zhvillime të pritshme do të çojnë drejt një rritjeje lineare deri në vitin 2031 sa trefishi i përqindjeve të vitit 2011, për emigruesit brenda vendit që drejtohen në Elbasan, Vlorë, Shkodër, dhe Korçë. Përqindjet e migruesve që drejtohen për në Gjirokastrë dhe Berat pritet të dyfishohen. Rëndësia në rritje e këtyre destinacioneve të-migrantëve nënkupton një rënie në pjesën e migrantëve të brendshëm drejt Tiranës dhe Durrësit nga dy të tretat në vitin 2011 në rreth 40% deri në vitin 2031.

Koeficientët specifike të emigrimit brenda vendit sipas gjinisë dhe grupmoshës janë mbajtur konstante sipas qarqeve gjatë periudhës së projeksionit, ashtu si dhe shpërndarja e migrantëve të brendshëm sipas qarqeve. Krahas kësaj, i njëjti nivel dhe trend i koeficientëve të mbijetesës në projeksionet në nivel kombëtar zbatohet për të gjitha qarqet.

SKENARËT

Hipotezat e ndryshme për vdekshmërinë, lindshmërinë dhe migrimin ndërkombëtar u kombinuan në tre skenarë për projeksionin e popullsisë deri në vitin 2031 në nivel kombëtar. *Skenari i rritjes së ulët* kombinon një vdekshmëri të lartë, lindshmëri të ulët dhe emigrim të lartë (dhe një imigrim të ulët) (HLH). Në *skenarin e rritjes së mesme* ruhen të gjitha hipotezat e mesme (MMM), ndërsa *skenari i rritjes së lartë* kombinon vdekshmërinë e ulët, lindshmërinë e lartë dhe emigrimin e ulët (dhe një imigrim i lartë) (LHL).

Ndjeshmëria e rezultateve të hipotezave vlerësohet nëpërmjet varianteve analitike të projeksioneve. Të gjitha ato bazohen në skenarin e rritjes së mesme por ndryshojnë sipas një supozimi të vetëm mbi vdekshmërinë, lindshmërinë, ose migrimin që zëvendësohet duke supozuar ose alternativën e ulët ose alternativën e lartë. Një projeksion i migrimit zero zbatohet gjithashtu për të ilustruar efektin e strukturës së moshës në ngjarjet demografike të ardhshme në Shqipëri si dhe për të dhënë informacion për kërkesa të mundshme për punë në vend.

Popullsia e qarqeve projektohet sipas skenarit të rritjes së mesme, i cili u rajonalizua në nivel qarku duke supozuar norma të njehta të ndryshimit në kohë të lindshmërisë dhe të migrimit ndërkombëtar ndërmjet qarqeve⁴. Kjo justifikohet nga ngjashmëria në tendencat e kaluara të lindshmërisë sipas qarqeve dhe shpërndarjes territoriale të emigrimit në të gjithë vendin. Krahas kësaj, zbatimi i normave të barabarta të ndryshimit bazohet gjithashtu tek fakti se lindshmëria dhe emigrimi duhet të pësojnë rënie me një ritëm më të shpejtë, aty ku nivelet fillestare janë më të larta se sa aty ku janë më të ulta.


Pra, skenarët e rritjes në nivel qarku ndryshojnë në thelb ndaj tendencave të pritshme të emigrimit brenda vendit dhe në rishpërndarjen gjeografike të migrantëve brenda Shqipërisë. Hipotezat kombinohen në gjashtë projeksione të rritjes së mesme, nga të cilat tre janë më me interes. *Skenari i migrimit të brendshëm të ulët* kombinon një emigrim të ulët brenda vendit me një imigrim gjeografikisht më të balancuar brenda vendit në të ardhmen (MMMLD). *Skenari i migrimit të brendshëm të mesëm* kombinon emigrimin konstant brenda vendit me një shpërndarje konstante të imigrantëve brenda vendit të përqendruar më shumë në Tiranë dhe në Durrës (MMMCC). *Skenari i migrimit të brendshëm të lartë* kombinon hipotezën e lartë të emigrimit brenda vendit me një shpërndarje konstante të imigrantëve brenda vendit (MMMHC).

Krahas kësaj, tre skenarët analitikë synojnë të japin një informacion për efektet respektive mbi ndryshimin e popullsisë në nivel qarku nisur nga hipotezat tona mbi nivelin dhe shpërndarjen hapësinore të migrimit të brendshëm. *Skenarët e migrimit të lartë (ose konstant) dhe me shpërqendrim hapësinor* supozojnë një rritje (ose nivel konstant) të emigrimit brenda vendit, por gjithashtu edhe një rënie në përqendrimin hapësinor të imigrimit brenda vendit. *Skenari i ulët dhe me shpërqendrim hapësinor* supozon një rënie të migrimit brenda vendit, i cili gjithsesi mbetet i përqendruar në Tiranë dhe Durrës.

⁽⁴⁾ Në parashikimet rajonale kemi përdorur vlerësime të tërthorta të lindshmërisë për Tiranën dhe Shkodrën sepse besojmë se shifra zyrtare e nënvlerëson nivelin (shihni Analizën për Prefekturat tek Shtojca).

4


Rezultatet



TENDENCAT E ARDHSHE TË POPULLSISË SË SHQIPËRISË

Popullsia e Shqipërisë nuk do ta arrijë nivelin maksimal të vitit 1989 deri në vitin 2031 (shih anën e majtë të Figurës 8). Skenari i rritjes së mesme parashikon një ulje të lehtë deri në vitin 2021 në 2.863.311 banorë, pasuar nga një rënie deri në 2.782.310 banorë në vitin 2031. Megjithatë, nëse lindshmëria rikuperohet nga niveli aktual dhe emigrimi pëson rënie me një ritëm të shpejtë (siç pritet në skenarin e rritjes së lartë), popullsia pritet të rritet vazhdimisht për të arritur vlerën më të madhe prej 3.033.017 banorë në vitin 2031. Rënia e fortë e lindshmërisë dhe emigrimi i supozuar në skenarin e rritjes së ulët duhet të çojnë drejt një rënieje të mprehtë në numrin e banorëve deri në nivelin e 2.503.751 (shihni gjithashtu statistikën e përmbledhura të Tabela 10 të Shtojcës). Këto tre skenarë nënkuptojnë një shtrirje në numrin e banorëve ndërmjet minus 14% dhe plus 4% të popullsisë së vitit 2011.

Figura 8. Tendencat në numrin (ana e majtë) dhe normën e rritjes (ana e djathtë) të popullsisë së Shqipërisë 1989-2031




Skenarët e rritjes së ulët dhe të lartë nënkuptojnë trajektore të ndryshme të demografisë në të ardhmen, veçanërisht gjatë dekadës së parë të projeksionit, që pasohet nga një periudhë me rritje konstante (shihni anën e djathtë të Figurës 8). Sipas skenarit të rritjes së lartë, norma vjetore e rritjes së popullsisë së përgjithshme duhet të kalojë nga niveli i saj negativ në vitin 2011 drejt një niveli pozitiv me 0,4% në vitin 2022 dhe më pas të shënojë një rënie në 0,2% në vitin 2030. Sipas skenarit të rritjes së ulët, norma e rritjes pëson rënie lineare në dhjetë vitet e para dhe mbetet më pas e qëndrueshme (tek -1%). Nëse rënia e lindshmërisë dhe emigrimit është më e ngadaltë (d.m.th. skenari i mesëm), Shqipëria duhet të përjetojë një rënie më pak të pjerrët në rritjen e popullsisë për të arritur në më pak sesa -0,4% në fund të periudhës së parashikimit.

Një vështrim më nga afër i komponentëve të popullsisë tregon se ekzistojnë shumë pak dyshime në lidhje me rritjen lineare të numrit të vdekjeve nga 19.804 në vitin 2011 në 28.212 në vitin 2031, me ndryshime shumë të vogla ndërmjet skenarëve (paneli i anës së majtë në Figurën 9). Megjithatë, tendenca vjetore në numrin e lindjeve ndryshon ndjeshëm. Skenari i rritjes së mesme parashikon një numër vjetor relativisht të qëndrueshëm deri në vitin 2017 (d.m.th mbi 34.000) dhe më pas një rënie në 25.223 në vitin 2030. Nëse lindshmëria rritet në mënyrë të vazhdueshme dhe emigrimi pëson ulje të shpejtë, për pasojë, numri i lindjeve duhet të rritet në nivelin e 40.204 në vitin 2022 dhe të bjerë pak deri në vitin 2030. Duke supozuar një rënie të fortë të lindshmërisë dhe nivele të larta të emigrimit si rrjedhojë do të kemi një rënie të fortë e të vazhdueshme të lindjeve deri në 27.165 në vitin 2030.

Ndryshimi ndërmjet numrit të lindjeve dhe vdekjeve është i barabartë me rritjen natyrore dhe tregohet në panelin e anës së djathtë të Figurës 9. Skenarët e rritjes së ulët dhe mesatare parashikojnë që rritja natyrore prej 15.761 individë në vitin 2011, të bëhet negative në vitin 2023 dhe 2028 respektivisht. Skenari i rritjes së lartë parashikon një tejkalim të vdekjeve mbi lindjet gjatë gjithë periudhës së projeksionit (me të paktën 9.000 në vit) megjithëse me një tendencë në rënie në dekadën e dytë. Pra, rritja natyrore e popullsisë do të pësojë rënie përpara vitit 2031 edhe kur rriten nivelet e lindshmërisë.

Figura 9. Tendencat e numrit të lindjeve dhe të vdekjeve, rritjes natyrore dhe migrimit neto, 2011-2031



Është interesante të krahasohen tendencat në lindjeve në skenarin e mesëm me ato të variantit me migrim zero. Diferenca jep informacion të rëndësishëm për efektin e strukturës së moshës ose, e thënë ndryshe, për efektin e plakjes në të ardhmen të grupeve të rinjve (të moshuarve), në (dhe jashtë) moshës së lindjes së fëmijëve. Nëse kufijtë do të ishin të mbyllur për 20 vitet e ardhshme, numri i lindjeve do të ishte rritur edhe më shumë deri në vitin 2020 në krahasim me parashikimin nga skenari i rritjes së lartë pavarësisht nivelit të ulët të lindshmërisë. Gjeneratat e lindura në vitet 1990 (grupmoshat 10 deri 19 vjeç në vitin 2011) janë në fakt më të shumta se sa ato të lindura në vitet 1980 (sepse gjeneratat e mëparshme janë pakësuar nga emigrimi i kaluar; shihni seksionin 4.3). Gjeneratat e mëparshme do të kishin një numër total lindjesh më të lartë kur të hynin në periudhën e krijimit të familjes në vitet 2010. Megjithatë në vitet 2020 numri i lindjeve do të pësojë rënie të shpejtë kur gjeneratat pasuese dhe më pak të numërtat që lindin në vitet 2000 të arrijnë moshën e lindjes së fëmijëve. Prej kësaj, tendenca në rënie e numrit të lindjeve e vërtetuar (herët ose vonë) në të gjitha skenarët nxitet nga struktura e parregullt e moshës së popullsisë shqiptare. Më konkretisht, numri i lindjeve do të bjerë ndërsa popullsia në moshat e lindjes së fëmijëve tkurret pas vitit 2021. Emigrimi i vazhdueshëm dhe lindjet e pakta do ta rëndojnë këtë efekt strukturor në kufizimin e rritjes natyrore në të ardhmen.

Migrimi ndërkombëtar neto manifeston një tendencë të kundërt me rritjen natyrore (paneli i anës së djathtë në Figurën 9). Duke filluar me një nivel të ngjashëm por negativ prej -19.000 individësh në vitin 2011, tendenca është në rritje megjithëse shtrirja dhe koha e kësaj rritjeje ndryshon sipas skenarit. Skenari i rritjes së lartë parashikon një rritje të madhe të migrimit neto, e cila gjithsesi mund të mbetet negative: nga -19.000 individë në vitin 2011 në -5.034 në vitin 2020, pasuar nga një rritje më e vogël. Skenari i rritjes së mesme parashikon një rritje të ngadaltë me -15.714 individë në vitin 2020, e cila intensifikohet në dekadën e dytë (duke arritur -6.965 individë në vitin 2031). Nga ana tjetër, skenari i rritjes së ulët parashikon një rënie fillestare të migrimit neto në -33.562 individë deri në vitin 2021, pasuar nga një ringritje e fortë në -15.992 individë në vitin 2030. Kjo rënie e fortë në balancën e migrimit gjatë dekadës së parë, pavarësisht një supozimi të rënies së nivelit të emigrimit, përsëri mund të shpjegohet nga efekte strukturore. Krahasuar me dekadën e parë të projeksionit, breza më të mëdhenj në numër do të hyjnë në mënyrë progresive në moshat më të prekura nga migrimi në vitet 2020, duke çuar drejt një numri total më të lartë të emigrantëve.


Pra, mund të dalim në përfundimin se popullsia shqiptare pëson një rënie të lehtë në skenarin e rritjes së mesme sepse rënia e rritjes natyrore kompensohet gjerësisht nga një rritje e migrimit neto. Në anën tjetër, rritja pozitive e popullsisë në skenarin e rritjes së lartë, rezulton nga efekti i kombinuar i rënies së vonuar dhe më pak të theksuar të rritjes natyrore, e cila mbetet pozitive dhe një trendi drejt migrimit të balancuar. Anasjelltas, rënia e theksuar demografike e parashikuar nga skenari i rritjes së ulët rezulton nga një rënie e fortë në rritjen natyrore, e cila mbështetet nga një balancë negative më evidente e migrimit.

Popullsia sipas grupmohave

Ecuria e ardhshme e popullsisë në Shqipëri dryshon shumë sipas grupmohave. Numri i të moshuarve me moshë 65 vjeç e lart parashikohet të rritet shumë, ndërsa numri i fëmijëve me moshë më pak se 15 vjeç do të vazhdojë të bjerë megjithëse disi më pak se sa gjatë 20 viteve të kaluara. Edhe popullsia në moshë pune (15 deri 64 vjeç) do të pësojë rënie.

Pavarësisht se gjenerata të mëdha do të arrijnë moshën e punës në dy dekadat e fundit, popullsia në moshë pune do të mbetet relativisht konstante (mbi 1.920.000) për shkak të emigrimit në shkallë të gjerë të rinjve (Figura 10). Nëse ky stabilizim vazhdon për dhjetë vitet e ardhshme, pritet një rënie e numrit të individëve të grupmohave nga 15 deri në 64 vjeç në vitet 2020. Skenari i rritjes së mesme parashikon një rënie prej 11% deri në 1.753.129 deri në vitin 2031. Skenarët e rritjes së ulët dhe të lartë japin një rënie prej 5% dhe 19%, respektivisht (duke çuar në 1.861.100 dhe 1.584.128 individë në vitin 2031). Popullsia në moshë pune do të rritet lehtë (në 2.088.928) nëse kufijtë mbeten të mbyllur.

Figura 10. Ndryshimi i numrit të popullsisë sipas grupmohave, 1989-2031



Numri i fëmijëve më pak se 15 vjeç gjithashtu do të bjerë nga 626.870 në vitin 2011 në 437.701 në vitin 2031 (d.m.th me 30%) sipas skenarit të rritjes së mesme. Skenari i rritjes së lartë parashikon një rënie 16% deri në 526.443 në vitin 2021, pasuar nga një ringritje deri në 567.224 në vitin 2031. Nga ana tjetër, skenari i rritjes së ulët parashikon një rënie të vazhdueshme me 44% deri në vitin 2031, duke çuar në një total prej 349.177 fëmijë.


Numri i të moshuarve me moshë 65 vjeç e lart rritet me 84% në krahasim me vitin 2011 për të arritur ndërmjet 570.445 dhe 604.693 individëve në vitin 2031. Kjo shpjegohet nga arritja e moshës së pensionit nga gjeneratat e foshnjave (të lindura ndërmjet viteve 1945 dhe 1960). Ato jo vetëm që janë më të shumta se gjeneratatat e mëparshme në sajë të shkallës më të madhe të lindshmërisë dhe rënies së shpejtë në vdekshmërinë (e foshnjave) në kohën e lindjes, por gjithashtu ishin më pak të prekura nga emigrimi i viteve 1990 e më pas, krahasuar me gjeneratat më të reja. Numri i individëve shumë të moshuar (me moshë 80 vjeç e lart) pritet të dyfishohet sipas të gjitha skenarëve, duke arritur në më shumë se 120.000 në vitin 2031.

Struktura moshore

Plakja e gjeneratave të njëpasnjëshme dhe ngjarjet demografike që ato provojnë me kalimin e kohës do të transformojnë strukturën e moshës së popullsisë shqiptare. Siç tregohen në Figurën 11, piramida e gjinisë dhe moshës do të zgjerohet në majë ndërsa brezat e foshnjave të lindura gjatë gjeneratës “baby-boom” kalojnë në moshën e pensionit. Krahas kësaj, plakja e gjeneratave të lindura në vitet 1990 (me moshë ndërmjet 10 dhe 20 vjeç në vitin 2011) do të rrisë numrin e të rriturve në moshat kryesore të lindjes së fëmijëve në vitin 2021 (shihni anën e majtë të Figurës 11). Megjithatë, dhjetë vjet më vonë këto gjenerata do të zëvendësohen nga gjeneratat e lindura më pas, që janë shumë më të pakta në numër, duke çuar drejt një numri të reduktuar të të rriturve në moshë për të lindur (paneli i anës së djathtë).

Krahas kësaj, meshkujt janë më dominues se femrat në moshat nga 20 deri 44 vjeç në vitin 2031, pavarësisht nga vdekshmëria e tyre më e lartë dhe shkalla e barabartë e emigrimit për të dy gjinitë. Të tre skenarët japin raportin 110 meshkuj për çdo 100 femra. Kjo disbalancë gjinore është pasojë e tendencës në rritje të raportit gjinor në lindje që nga viti 1989. Pra në të ardhmen pritet të ketë një mungesë të femrave në moshë martese, gjë e cila kufizon perspektivën për një pjesë të meshkujve që duan të krijojnë familje.

Figura 11. Piramidat e popullsisë së Shqipërisë për vitin 2011, 2021 dhe 2031




Migrimi negativ neto në të ardhmen do të shterojë kryesisht grupmoshat midis 10 dhe 25 vjeç në vitin 2011. Ky emigrim i çifteve në moshë riprodhimi, kombinuar me një normë më të ulët lindshmërie të parashikuar nga skenari i rritjes së ulët dhe të mesme, çon drejt një numri më të vogël të fëmijëve duke përsheptuar tkurrjen e bazës së piramidës së popullsisë. Nga ana tjetër, skenari i rritjes së lartë projekton një bazë më të gjerë për shkak të supozimit të emigrimit të ulët dhe lindshmërisë së lartë, gjë e cila rrit numrin e përgjithshëm të lindjeve.

Moshimi i popullsisë së Shqipërisë

Tendencat e ndryshme të popullsisë sipas grupmoshave nënkuptojnë një proces demografik të plakjes së popullsisë. Moshë medianë (d.m.th. në të cilën gjysma e popullsisë është më e re dhe gjysma tjetër më e vjetër) parashikohet të ketë një rritje të vazhdueshme, megjithëse në një masë më të vogël kur krahasohet me të kaluarën e vonë (Figura 12): do të arrijë në 41,7 vjeç në vitin 2031 në përputhje me skenarin e mesëm të rritjes, me një interval prej 40,0 dhe 43,6 vjet në përputhje me skenarin e ulët të rritjes dhe atë të lartë (nga 32,6 në vitin 2011). Shqipëria do të ketë arritur moshën aktuale medianë të Evropës deri nga fundi i periudhës së projeksionit.

Figura 12. Ndryshimi i moshës medianë të popullsisë dhe i koeficientëve të varësisë të të rinjve dhe të të moshuarve, për vitet 1989-2031




Popullsia e Shqipërisë jo vetëm që do të plakët, por strukturat e moshimit parashikohen të transformohen në të ardhmen. Deri në vitin 2011, plakja nxitej nga tkurrja e brezave të lindur d.m.th plakje në bazë të piramidës: raporti i varësisë të të rinjve pësoi rënie nga 53 fëmijë për 100 të rritur në moshë pune në vitin 1989 në 32 fëmijë në vitin 2011. Deri tani varësia e të moshuarve ka qenë e kufizuar, megjithëse ajo është dyfishuar nga 8 në 16 individë për 100 të rritur në moshë pune. Varësia e të rinjve parashikohet të bjerë me një ritëm të ngjashëm krahasuar me rritjen e varësisë të të moshuarve deri në vitin 2021 (një rënie deri në 25 të rinj dhe një rritje deri në 23 të moshuar për 100 të rritur në moshë pune respektivisht, sipas skenarit të rritjes mesatare). Në dekadën e dytë të projeksioneve, tendenca e varësisë të të rinjve varet nga skenari, me një tendencë stabilizimi ose të një rënieje të lehtë. Skenari i rritjes së lartë nënkupton një ringritje për shkak të supozimeve të lindshmërisë së lartë dhe humbjeve të vogla nga migrimi. Tendenda në rritje e varësisë të të moshuarve, në kontrast, duhet të intensifikohet kur brezat e foshnjave të lindura gjatë gjeneratës baby-boom të fillojnë të arrijnë moshën e pensionit në vitet 2020. Skenari i rritjes së mesme nënkupton 30 të moshuar për 100 të rritur në moshë pune në vitin 2031. Nëse plakja e avancuar ndodh kur raporti i varësisë të të moshuarve kalon atë të të rinjve, atëherë fillimi i saj në Shqipëri mund të pritët përpara vitit 2025.

VLERËSIMI I NDJESHMËRISË SË PROJEKSIONEVE NDAJ HIPOTEZAVE

Për të analizuar ndjeshmërinë e rezultateve të projeksioneve ndaj tendencave të supozuara të lindshmërisë, migrimit dhe vdekshmërisë, ne krahasuam skenarin e rritjes së mesme me variantet e tij analitike që ndryshojnë nga ai, nga hipoteza e ulët apo e lartë ose për migrimin ose për lindshmërinë. Ky ushtrim gjithashtu synon të identifikojë faktorët kryesorë demografik të ndryshimeve të ardhshme të popullsisë në Shqipëri: sa më të mëdha diferenat në rezultatet e këtyre varianteve, krahasuar me skenarin e mesëm (referencë), aq më përcaktuese për të ardhmen demografike të Shqipërisë është tendenca në komponentin demografik për të cilin është zëvendësuar një hipotezë tjetër. Figura 13 krahason projeksionet e popullsisë gjithsej sipas skenarit të rritjes së mesme me variantet e tij (meqë ndryshimet në supozimet e vdekshmërisë kanë një impakt të vogël mbi popullsinë e përgjithshme, ato variante nuk janë shfaqur).

Figura 13. Tendanca e numrit të popullsisë sipas skenarit të rritjes së mesme dhe varianteve të tij për vitet 1989-2031




Rezultatet konfirmojnë një rol më të madh në ndryshimin e ardhshëm demografik të sjelljes migruese dhe strukturës së moshës në krahasim me tendencat e lindshmërisë (dhe vdekshmërisë). Variantet që japin një emigrim të ulët ose të lartë parashikojnë respektivisht një popullsi të përgjithshme prej 2,917,012 ose 2,552,504 individësh në vitin 2031, duke nënkuptuar një diferencë prej +4,8% ose -8,3% të lidhura me skenarin e rritjes së mesme. Diferenca është më e madhe në variantin me migrim zero (+14,5% në vitin 2031), sepse grupet në moshë pune janë më pak të shteruara dhe kanë një numër të përgjithshëm fëmijësh më të lartë, në krahasim me skenarin e mesëm.

Variantet që supozojnë një lindshmëri të ulët apo të lartë nënkuptojnë një popullsi të përgjithshme prej 2,734,755 ose 2,883,143 individësh në vitin 2031, e cila përfaqëson një ndryshim të vogël me skenarin me referencë të rritjes së mesme, respektivisht prej -1,7% dhe +3,6%. Pra, për shkak të normave të larta në fillim, projeksionet kombëtare janë më të ndjeshme ndaj supozimeve për sjelljen migruese ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, trajektorja demografike e ardhme e Shqipërisë do të jetë përcaktuar në mënyrë të konsiderueshme nga efektet e strukturës së parregullt të moshës siç vërehet në vitin 2011. Kalimi në moshat kryesore të lindjes së fëmijëve dhe të migrimit, i grupeve relativisht të mëdha të lindura në vitet 1990, do të influencojë në tendencat e supozuara të sjelljes, përsa i përket ngjarjeve demografike (lindjet dhe emigrimet) respektivisht në vitet 2010 dhe 2020. Ndryshimet në sjelljen e lindshmërisë do të kenë një impakt demografik më të vogël dhe zhvillimi i ardhmshëm në vdekshmëri ndikon vetëm marginalisht tendencat e popullsisë, sepse popullsia e Shqipërisë është ende relativisht e re.

SKENARI I RITJES SË MESME I SHTRIRË DERI NË VITIN 2060


Duke pasur parasysh kontekstin demografik dinamik të Shqipërisë, shtrirja e çdo projeksioni vlerësues përtej periudhës prej 20 vitesh është një ushtrim i rrezikshëm. Skenari i rritjes së mesme deri në vitin 2060 duhet të trajtohet me kujdes dhe të interpretohet si një tregues i përafërt i një tendence të mundshme. Rezultatet e parashikimit tregojnë një intensifikim të rënies demografike pas vitit 2031 për të arritur në 2.3 milion banorë në vitin 2060 (Figura 14). Popullsia në moshë pune do të pësojë rënie për të arritur në më pak se 1.4 milion për shkak të efekteve strukturore: brezat e shumtë në numër, të lindur pas viteve 1990, do të arrijnë moshën e pensionit dhe do të zëvendësohen në mënyrë të konsiderueshme me breza më të vegjël në numër, që arrijnë moshën për punë. Popullsia e fëmijëve pritet të pësojë rënie të vazhdueshme deri nën 300.000 në vitin 2060, ndërsa numri i të moshuarve pritet të stabilizohet mbi 600.000 nga viti 2040 e në vazhdim.

Figura 14. Tendenca e numrit të përgjithshëm të popullsisë, popullsisë në moshë pune, të rinjve dhe të moshuarve në vitet 2011-2060




Norma e rritjes së popullsisë pritet të zvogëlohet me një ritëm të shpejtë për të arritur 0.8% në 2060 (Figura 15), në mënyrë të ngjashme me normën e vërtetuar në vitet 2000. Arsyeja për përshpejtimin e shpopullimit qëndron në faktin se rritja natyrore do të bëhet shumë negative (-17.000 individët në 2060). Niveli negativ i imigrimit neto pritet të bëhet i parëndësishëm në 2031 (pavarësisht supozimit të normave konstante të emigracionit nga 2031 e në vazhdim) për shkak të numrit të ulët të emigrantëve që vjen si rezultat i një popullsie të pakësuar të të rriturve të rinj.

Figura 15. Norma e rritjes, numri i rritjes natyrore dhe migrimi neto, 2011-2060



Plakja demografike do të përparojë me një ritëm të shpejtë, veçanërisht në vitet 2020 dhe 2050 kur respektivisht, brezi i lindjeve "baby-boom" (të moshës 45-64 vjeç në vitin 2011) dhe të rinjtë e sotëm të arrijnë moshën e pensionit (Figura 16). Një i moshuar mund të duhet të mbështetet vetëm nga dy individë në moshë pune në vitin 2060. Në të kundërt, koeficienti i varësisë të të rinjve pritet të pësojë rënie me dy fëmijë për 10 të rritur në moshë pune.

Figura 16. Koeficienti i varësisë të të rinjve dhe të të moshuarve dhe piramidat e popullsisë për vitet 2011-2060



Pra, piramida e popullsisë shqiptare do të transformohet në të ardhmen në një strukturë në formë zileje me një bazë shumë të ngushtë (Figura 16). Shumica e banorëve do të jenë të moshës 50 vjeç e lart në vitin 2060.

PROJEKSIONET E POPULLSISË NË NIVEL QARKU


Sipas skenarëve të rajonalizuar të rritjes së mesme për vitin 2031, në shumicën e qarqeve popullsia do të zvoglohet, përveç Tiranës, Durrësit dhe Vlorës (Figura 17).

Numri i banorëve në qarkun e Tiranës parashikohet të rritet me më pak se një e pesta, nga 763.560 banorë në vitin 2011 në 909.252 banorë në vitin 2031, sipas skenarit të ulët të migrimit të brendshëm, i cili parashikon gjithashtu një lëvizje të migrantëve në qendra të tjera të Shqipërisë. Supozimi i një lëvizshmërie të brendshme të fokusuar gjeografikisht dhe në rritje (skenari i lartë) do ta rriste popullsinë e qarkut të Tiranës me më pak se një e treta, për të arritur pothuaj 1 milion banorë (aglomerimi urban i Tiranës aktualisht është më i madh, sepse shtrihet edhe në qarkun e Durrësit dhe të Elbasanit). Skenari i mesëm i migrimit të brendshëm (që supozon një strukturë teritoriale dhe nivel të migrimit konstant) nuk është larg nga ky prag (951.338 banorë në vitin 2031). Rritja e popullsisë gjatë dy dekadave të tjera do të jetë shumë më e kufizuar në Vlorë (ndërmjet 3% dhe 12%) dhe në Durrës (maksimumi 7%).

Shpopullimi më i madh parashikohet për qarqet e Dibrës dhe Kukësit në Veri (-30% e lart deri në vitin 2031, sipas skenarit të mesëm të migrimit të brendshëm), si dhe për Gjirokastrën dhe në një shkallë më të vogël për Beratin në Jug (të paktën -20%). Qarqet e tjera do të provojnë një rënie të numrit të banorëve që varion ndërmjet 10% dhe 20% gjatë njëzet viteve të ardhshme.

Duhet pasur parasysh se të gjitha këto skenarë të migrimit të brendshëm bazohen në të njëjtin skenar të rajonalizuar të rritjes së mesme në nivel kombëtar, i cili supozon një rënie të lehtë të lindshmërisë dhe emigrimit deri në vitin 2031. Në rastin e një rënieje të shpejtë ose një trendi të kundërt, si ai që supozohet në skenarët e rritjes së ulët dhe të lartë në nivel kombëtar, popullsia e qarqeve në vitin 2031 mund të jetë 9% respektivisht më e ulët ose më e lartë në varësi të skenarit të përdorur kur krahasohet me rezultatet në Figurën 17. Kjo gamë është më e madhe se sa ndryshimet që shihen ndërmjet skenarëve të migrimit të brendshëm. Përderisa emigrimi është më i lartë sesa emigrimi brenda vendit në shumicën e qarqeve, ky komponent demografik është me të vërtetë më i rëndësishëm për të ardhmen demografike të qarqeve në Shqipëri.


Figura 17. Ndryshimi i popullsisë së përgjithshme dhe popullsisë në moshë pune (moshat 15-64 vjeç) sipas tre skenarëve të migrimit të brendshëm për qarqet e Shqipërisë, 2011-2031



Shënim: Skenarët e rajonalizuar të rritjes së mesme sipas niveleve të ndryshme të emigrimit brenda vendit dhe shkallët e ndryshme të përqëndrimit territorial të migrantëve të brendshëm.

Popullsia në moshë pune do të bjerë me një ritëm pak më të shpejtë se sa popullsia e përgjithshme: me më shumë sesa 18% në pothuaj të gjitha qarqet (Figura 17), përveç atyre që e shtojnë popullsinë nëpërmjet migrimit (Tirana, Vlora dhe Durrësi). Tirana është qarku i vetëm në të cilin parashikohet një rritje e konsiderueshme në forcën potenciale të punës (me 20% deri në vitin 2031, sipas skenarit të mesëm me shpërndarje gjeografike dhe emigrim konstant brenda vendit). Rënia më e fortë në forcën e mundshme të punës parashikohet për Gjirokastrën (me -43%), si dhe për Beratin dhe Dibrën (me të paktën -30%). Nëse niveli i migrimit të brendshëm rritet së bashku me rënien e emigrimit dhe nëse do të ketë një diversifikim të destinacioneve të brendshme, popullsia në moshë pune do të tkurret në një shkallë më të vogël, veçanërisht në ato qarqe ku supozohet të ketë një rritje të tërheqjes për migrantët (Korçë, Gjirokastrë, Elbasan, Berat, por edhe në Lezhë; shih Tabelat përmbledhëse dhe piramidat e popullsisë të Shtojcat).

Figura 18. Raporti i popullsisë së qarqeve në vitin 2031 ndaj asaj të vitit 2011 dhe përpjesat e popullsisë së tyre ndaj totalit kombëtar sipas tre skenarëve të migrimit të brendshëm, 2011-2031




Shënim: Skenarët e rajonalizuar të rritjes së mesme sipas niveleve të ndryshme të emigrimit brendshëm brenda vendit dhe shkallët e ndryshme të përqendrimit territorial të migrantëve të brendshëm.

Këto tendenca do të rrisin përqendrimin territorial të popullsisë në të ardhmen. Pjesa e popullsisë së përgjithshme që jeton në qarkun e Tiranës parashikohet të rritet nga 26% në vitin 2011 në 35% sipas skenarit të migrimit të brendshëm të mesëm (Figura18).

Moshimi demografik do të përparojë më shpejt në Jug me diferenca të vogla ndërmjet skenarëve (Figura19). Në vitin 2031, mund të ketë pothuaj 30 banorë me moshë 65 vjeç e lart për 100 banorë në moshë pune në Berat, Korçë dhe Vlorë. Në Gjirokastrë raporti do të arrijë në 34, ose dyfishin e nivelit aktual. Varësia e të moshuarve do të mbetet e ulët në Kukës dhe Dibër e cila shpjegohet me breza më të pakët në moshën e daljes në pension dhe lindshmërinë e lartë deri vonë. Rritja e varësisë demografike të të moshuarve do të mbetet e kufizuar në Tiranë, Durrës dhe Elbasan, ku popullsia në moshë pune parashikohet të rritet vazhdimisht, prej lëvizjeve të brendshme nga qarqet e tjera të Shqipërisë dhe nga jashtë shtetit.

Figura 19. Koeficienti i varësisë të të moshuarve sipas tre skenarëve të migrimit të brendshëm për qarqet e Shqipërisë për vitet 2011-2031



Shënim: Skenarët e rajonalizuar të rritjes së mesme sipas niveleve të ndryshme të emigrimit të brendshëm brenda vendit dhe shkallët e ndryshme të përqendrimit territorial të migrantëve të brendshëm.

Projeksionet për secilën prefekturë janë përmbledhur në Tabelat dhe Piramidat e treguara të Shtojcat. Ato nxjerrin në pah disa transformime në dinamikën demografike të qarqeve. Përderisa është marrë si bazë e njëjta shkallë rënieje në emigrim për të gjitha qarqet, nivelet priren të konvergojnë. Megjithatë deri kohët e fundit, rritja demografike vinte në një shkallë të konsiderueshme nga rritja natyrore në të gjitha qarqet, kjo pritet të ndryshojë në të ardhmen.

Shumica e qarqeve do të provojnë një rënie në numrin e lindjeve. E kombinuar me rritjen e vdekjeve në të gjithë Shqipërinë, qarqet do të provojnë një rënie në rritjen natyrore të popullsisë në të ardhmen. Tirana është qarku i vetëm ku rritja natyrore do të mbetet pozitive, rrjedhojë e një strukture më të favorshme të moshës që lidhet me migrimin e brendshëm, kryesisht nga vajzat, gjë që rrit brezat në moshën e lindjes së fëmijëve (pra rritet numri i lindjeve dhe zvoglohet përpjesa e vdekjeve kundrejt popullsisë gjithsej). Megjithatë në rastin e Durrësit, struktura territoriale e migrimit të brendshëm në të ardhmen duhet të mbetet e fokusuar në zonën Tiranë - Durrës, në mënyrë që migrimi i brendshëm neto të mbështesë indirekt rritjen natyrore të popullsisë.

Kukësi dhe Dibra (dhe, në një masë më të vogël, Shkodra) janë përjashtime të tjera për shkak të rënies së vonuar historike të lindshmërisë. Gjirokastra, në ndryshim nga ato, do të provojë një rënie natyrore më të fortë (-0,5% në vitin 2031), duke reflektuar fillimin e hershëm të tranzicionit të lindshmërisë kombinuar me emigrimin masiv dhe një migrim brenda vendit nga ky qark. Pra, nëse niveli i lindshmërisë për vendin bie aq ngadalë sa parashikohet në skenarin e rritjes së mesme dhe nëse qarqet vazhdojnë me një trend të ngjashëm, në të ardhmen lëvizshmëria e popullsisë do të jetë dominuese në rritjen demografike.

Si rrjedhojë në 12 qarqet e Shqipërisë mund të dallohen pesë lloje të ndryshme të ecurisë demografike. Në Tiranë, Vlorë dhe Durrës stabilizimi ose rritja e popullsisë pritet të nxitet nga migrimi i brendshëm neto pozitiv, si dhe nga migrantët e kthyer në rastin e Vlorës.

Grupi i dytë përbëhet nga Kukësi dhe Dibra, të cilat pavarësisht nga një tejkalim në diferencën e lindjeve kundrejt vdekjeve do të provojnë një rënie të fortë të popullsisë për shkak të balancës shumë negative të migrimit të brendshëm që përfaqëson të paktën trefishin e migrimit neto ndërkombëtar, sipas skenarit të mesëm për migrimin e brendshëm. Megjithatë, nëse niveli i emigrimit brenda vendit pëson rënie, ulja e numrit të popullsisë do të rezultojë po aq nga lëvizjet e brendshme sa edhe nga largimet ndërkombëtare.

Berati dhe Fieri formojnë grupin e tretë. Pavarësisht nga një nivel negativ i rritjes natyrore, zvoglimi i popullsisë në këto qarqe do të vijë kryesisht nga migrimet e brendshme dhe ato ndërkombëtare (dominimi i njërës mbi tjetrën varet nga supozimi i nivelit dhe përqendrimit territorial të migrimit të brendshëm).


Grupi i katërt përfshin Korçën dhe Gjirokastrën, të cilat mund të dallohen nga rëndësia e barabartë e rritjes natyrore negative dhe e migrameve ndërkombëtare dhe të brendshme neto negative në rënien demografike.

Lezha, Elbasani dhe Shkodra formojnë grupin e fundit të karakterizuar nga një tendencë drejt një numri të balancuar të lindjeve dhe vdekjeve. Rënia demografike deri në vitin 2031 nxitet kryesisht nga migrimi ndërkombëtar (përveçse kur migrimi i brendshëm rritet në të ardhmen).

Si përfundim, një rënie në emigrimin ndërkombëtar deri në vitin 2031 sa një e treta e nivelit të vëzhguar në vitet 1990, në të gjitha qarqet, kombinuar me një ulje të lehtë të lindshmërisë, nënkupton një shpopullim deri në 40% në shumicën e qarqeve (përveç Tiranës, Vlorës dhe Durrësit). Migrimi i brendshëm do të luajë një rol të vogël në dinamikën e popullsisë në të ardhmen sepse niveli i tij është shumë më i ulët kur krahasohet me migrimin ndërkombëtar. Duke pasur parasysh përqendrimin e fortë territorial të lëvizjeve të brendshme, këto do të mund të përcaktojnë në mënyrë të konsiderueshme tendencat demografike në rajonet kryesore të origjinës dhe destinacionit për qarqe si: Kukësi, Dibra, Tirana, Durrësi dhe Vlora.

5

Konkluzionet



Shqipëria provoi ndryshime demografike të theksuara gjatë njëzet viteve të fundit. Nga rritja më e lartë e popullsisë në Evropë gjatë periudhës së pas luftës, Shqipëria ka kaluar në rënie të popullsisë që nga viti 1990. Më shumë se një milion Shqiptarë kanë emigruar në vende të huaja, veçanërisht ata nga zonat periferike. Së bashku me migrimin e brendshëm, kjo çoi drejt një përqendrimi të popullsisë në qendrat kryesore urbane dhe rreth tyre. Megjithatë kjo rishpërndarje e popullsisë fillimisht u nxit nga kriza post-komuniste, në dekadën e fundit migrimi ndërkombëtar dhe i brendshëm kanë ndodhur gjithnjë e më shumë për arsye familjare dhe strategji për kërkim mundësish dhe ka përfshirë kryesisht të rinj dhe gjithnjë e më shumë gra. Kombinuar me një rënie të fortë të niveleve të lindshmërisë në Shqipëri, kjo e intensifikoi uljen e numrit të lindjeve, duke zvogluar kështu përpjesën e fëmijëve në popullsinë e përgjithshme. Në të njëjtën kohë, përpjesa e të moshuarve në popullsi u rrit sepse breza të shumtë të të lindurve në periudhën e hershme komuniste po arrijnë aktualisht moshën e pensionit, duke çuar drejt një procesi të shpejtë të plakjes së popullsisë.

Këto tendenca të fundit demografike do të vazhdojnë në të ardhmen. Tendencat e popullsisë në Shqipëri do të përcaktohen kryesisht nga sjelljet migratore dhe të lindshmërisë. Efektet e tyre demografike do të rriten në vitet 2010-2020 nga hyrja e brezave relativisht të shumtë të të rinjve në moshën e migrimit dhe të lindjes së fëmijëve. Sipas skenarëve të ndryshme të rritjes së popullsisë, numri i banorëve do të variojë ndërmjet 2.503.751 dhe 3.033.017 në vitin 2031, që përfaqëson respektivisht një humbje prej 14% dhe një rritje të lehtë prej 4% përkundrejt vitit 2011. Edhe nëse popullsia në moshë pune do të stabilizohet gjatë dhjetë viteve të ardhshme (rreth 1.920.000 persona), ajo pritet të ulet rreth 11% deri në vitin 2031. Në mungesë të migrimit ndërkombëtar, popullsia në moshë pune do të rritej pak, mbi dy milion.

Sfondi demografik në Shqipëri pritet të transformohet në të ardhmen. Nga moshimi i brezave që i përkasin gjeneratës "baby-boom", numri i vdekjeve do të rritet me më pak se gjysma, ndërsa numri i lindjeve do të ulet kur brezat e lindur në vitet 2000 do të hyjnë në moshën e lindjes së fëmijëve përveç rastit kur nivelet e lindshmërisë rriten në të ardhmen. Numri i vjetor i vdekjeve pritet të jetë më i lartë sesa numri i lindjeve në vitin 2031. Megjithatë, nëse brezat e rinj vazhdojnë të emigrojnë dhe të ulin më shumë lindshmërinë e tyre, Shqipëria do të pësojë një rënie natyrore të popullsisë nga fillimi i viteve 2020. Krahas kësaj, raporti gjinor i lartë në lindje që nga vitet 1990 do të çojë në një disbalancë gjinore në rritje në popullsinë e ardhshme të moshës së riprodhimit, gjë e cila mund të kufizojë perspektivën e krijimit të familjes nga një pjesë e konsiderueshme e meshkujve.

Rënia e rritjes natyrore të popullsisë do të mund të kompensohet vetëm pjesërisht nga humbje të vogla demografike, rrjedhojë e migrimit ndërkombëtar në të ardhmen. Me reduktimin e motiveve për tu larguar jashtë shtetit si pasojë e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, nivelet e emigracionit priten të bien. Megjithatë për shkak se popullsia në moshën kulmore të emigrimit do të rritet gjatë dhjetë viteve të ardhshme, numri i emigrantëve do të tejkalojë nga 5.000 në 16.000 numrin e imigrantëve në vitin 2021. Kjo do të pasohet nga një rënie e shpejtë e numrit të emigrantëve, duke çuar drejt një balancimi pothuaj neutral të migrimit deri në vitin 2030. Në varësi të performancës ekonomike relative të Shqipërisë në krahasim me vendet e tjera Evropiane, që mund të çojë në ofrimin e mundësive në tregun e punës për banorët e rinj dhe të kthyerit nga emigrimi, projeksionet tregojnë një numër prej 100.000 deri në 300.000 më shumë emigrantë sesa imigrantë gjatë njëzet viteve të ardhshme.

Lindshmëria e ulët dhe emigrimi i vazhdueshëm (sa do që më i ulët) në të ardhmen do të ishin shkaqet kryesore të ndryshimit të strukturës moshore të popullsisë së Shqipërisë. Numri i fëmijëve do të vazhdojë të bjerë (me një të katërtën) dhe numri i të moshuarve do të rritet me më shumë se katër të pestat deri në vitin 2031. Kjo do të çojë drejt arritjes së plakjes së avancuar të popullsisë të vërtetuar në Evropë, me më shumë varësi të të moshuarve në krahasim me fëmijët. Kalimi nga një popullsi me dominancë të varësisë të të rinjve në një dominancë të varësisë të të moshuarve mund të zgjasë vetëm një brez në Shqipëri, krahasuar me një gjysmë shekulli në Evropën Perëndimore.

Tendencat e fundit demografike parashikohet të shfaqen edhe në nivel qarku. Rritja e popullsisë deri në vitin 2031 mund të pritet vetëm për Tiranën (deri në 30%) dhe, në një masë më të vogël, për Vlorën dhe Durrësin sepse këto qarqe përbëjnë destinacionet fillestare të imigrimit ndërkombëtar dhe të brendshëm. Tirana është qarku i vetëm në të cilin popullsia në moshë pune mund të rritet. Rënia më e madhe në numrin e banorëve deri në vitin 2031 parashikohet për qarqet e Veriut dhe të Jugut (deri në -30%).

Rritja natyrore negative e popullsisë do të përfshijë pjesën më të madhe të qarqeve në të ardhmen, përveç qarqeve me një fillim më të vonshëm të rënies së lindshmërisë (si në Veri) dhe qendrat ekonomike që thithin shumicën e migrantëve të rinj të brendshëm të cilët pritet të kenë fëmijë në ato destinacion. Plakja e popullsisë do të përparojë më shpejt në Jug për shkak të fillimit të hershëm të tranzicionit të lindshmërisë dhe emigrimit në shkallë të gjerë që nga vitet 1990. Kjo dinamikë demografike rajonale do të nxjerrë në pah përqendrimin gjeografik të popullsisë së Shqipërisë në qendrat kryesore ekonomike në vend, dhe veçanërisht në Tiranë. Sipas skenarit të rritjes së mesme, deri në vitin 2031, 45% e popullsisë pritet të banojë në qarkun e Tiranës dhe të Durrësit (kundrejt 35 % në vitin 2011).

Rezultatet e detajuara të skenarëve të ndryshëm të projeksioneve në nivel kombëtar mund të gjenden te Shtojcat. Në nivel kombëtar, skenari i rritjes së ulët jep një parashikim minimal të mundshëm sepse parashikon një rënie të shpejtë të lindshmërisë dhe një rënie të ngadaltë të emigrimit në të ardhmen. Skenari i rritjes së shpejtë përfaqëson kufirin e sipërm të parashikimeve sepse lindshmëria pritet të rritet nga nivelet e ulta aktuale dhe emigrimi të bjerë me një ritëm të shpejtë. Skenari i rritjes së mesme supozon një tendencë të ndërmjetme të ndryshimit të komponentëve demografikë dhe jep një parashikim të mesëm. Rezultatet e detajuara në nivel prefekturash të Shtojcave i referohen këtij skenari të rritjes së mesme, i cili u rajonalizua sipas qarqeve duke supozuar një nivel konstant të emigrimit brenda vendit dhe një përqendrim territorial të qëndrueshëm të imigrantëve brenda vendit. Megjithatë këto rezultate duhet të përdoren me kujdes sepse tendencat alternative të emigrimit (ndryshe nga ato të supozuara në skenarin e mesëm) do të çonin drejt ndryshimeve të rëndësishme të popullsisë në nivel prefekturash.

6

Shtojcat

SHTOJCA 1: FJALORTHË DHE METODAT

Fjalorth

<i>Koeficientët specifike të Lindshmërisë</i>	Lidhen me numrin e lindjeve të grave në një grupmoshë të caktuar, në një vit të dhënë kalendarik, kundrejt popullsisë së grave të asaj grupmoshe në mes të vitit.
<i>Vdekshmëria e fëmijëve</i>	Probabiliteti i vdekjes ndërmjet lindjes dhe moshës 5 vjeç, për 1.000 lindje.
<i>Brez</i>	Një grup njerëzish që ndajnë një përvojë demografike të përkohshme të përbashkët, të cilët vëzhgohen në kohë. Brezi i lindjeve (i quajtur edhe 'gjeneratë') i vitit 1900 janë njerëzit e lindur në atë vit.
<i>Koeficienti Bruto i Lindshmërisë (KBL)</i>	Raporti i numrit të lindjeve të gjalla të një viti ndaj numrit gjithsej të popullsisë të të njëjtit vit. Shpesh ky koeficient shprehet për 1.000 banorë.
<i>Koeficienti Bruto i Vdekjeve (KBV)</i>	Raporti i numrit të vdekjeve të një viti ndaj numrit gjithsej të popullsisë të të njëjtit vit. Shpesh ky koeficient shprehet për 1.000 banorë.
<i>Emigrim</i>	Largim nga territori kombëtar për të paktën 12 muaj.
<i>Indeksi Sintetik i Migrimit (ISM)</i>	Numri mesatar i migrimeve që një brez hipotetik individësh do të provonin deri në fund të jetës së tyre nëse do të ishin subjekt gjatë të gjithë jetës i shkallës së migrimit në një periudhë të caktuar kohe (dhe nëse nuk janë subjekt i vdekshmërisë). Shprehet si migrime për çdo individ.
<i>Jetëgjatësia në lindje (E0)</i>	Numri mesatar i viteve të jetës i pritshëm për një grup hipotetik individësh, të cilët do të jenë subjekt gjatë gjithë jetës së tyre i normave specifike të vdekshmërisë të një periudhe të caktuar. Shprehet me vite.
<i>Mosha medianë</i>	Mosha në të cilën gjysma e popullsisë është më e re dhe gjysma tjetër është më e vjetër.
<i>Migrimi brenda vendit</i>	Largim nga një rajon i një vendi tek një rajon tjetër i po atij vendi.
<i>Imigrim</i>	Mbërritja dhe qëndrimi në një territor kombëtar për të paktën 12 muaj.
<i>Vdekshmëria foshnjore</i>	Probabiliteti i vdekjes ndërmjet lindjes dhe moshës 1 vjeç për çdo 1.000 lindje.
<i>Imigrim brenda vendit</i>	Ardhja nga një rajon i një vendi tek një rajon tjetër i po atij vendi.
<i>Migrimi neto</i>	Numri neto i migrantëve, d.m.th, numri i imigrantëve minus numrin e emigrantëve.
<i>Koeficienti i migrimit neto (MN)</i>	Efekti neto i imigracionit dhe i emigracionit mbi popullsinë e një territori, shprehur si rritje apo zvogëlim në përqindje, në një vit të dhënë.
<i>Shkalla e rritjes natyrore (RRN)</i>	Është koeficienti me të cilin një popullsi po rritet (ose po zvogëlohet) në një vit të dhënë në sajë të shtesës së lindjeve mbi vdekjet, shprehur si përqindje ndaj popullsisë bazë.
<i>Raporti Gjinator</i>	Numri i meshkujve për çdo 100 femra në popullsi.
<i>Raporti Gjinator në Lindje</i>	Raporti i meshkujve të lindur për çdo 100 femrave të lindura.
<i>Indeksi sintetik i fekunditetit (ISF)</i>	Numri mesatar i fëmijëve që një grup hipotetik grash do të ketë në fund të periudhës riprodhuese të tyre nëse ato do të ishin subjekt gjatë gjithë jetës së tyre ndaj koeficientëve specifike të lindshmërisë së një periudhe të dhënë. Shprehet me fëmijë për grua.
<i>Koeficienti i Varësisë të të Moshuarve (KVM)</i>	Raporti i numrit të të moshuarve (me moshë 65 vjeç e lart) kundrejt popullsisë në moshë pune (15-64 vjeç).
<i>Koeficienti i Varësisë të të Rinjve (KVR)</i>	Raporti i numrit të fëmijëve (0-14 vjeç) kundrejt popullsisë në moshë pune (15-64 vjeç).

Metodat

Vlerësimet e përqindjeve të emigrimit ndërmjet dy Censuseve, duke përdorur tabelën e jetës (metoda e të mbijetuarve) bazuar në Censusin e viteve 1989, 2001 dhe 2011:

Popullsia e regjistruar sipas grupmoshës dhe gjinisë në censusin e parë, si dhe numri vjetor i lindjeve në intervalin ndërmjet censuseve, u projektuan të mbijetojnë në datën e censusit të dytë (duke dhënë një vlerësim të popullsisë hipotetike të mbyllur), e cila u krahasua me popullsinë e regjistruar në Censusin e dytë (në vitin 2011, ne kemi marrë në konsideratë vetëm popullsinë banuese në Shqipëri në vitin 2001); pjesa e mbetur është një vlerësim i grupit të emigrantëve. Më pas vlerësuam nivelin e tranzicionit të emigracionit ndërmjet censuseve (duke marrë parasysh vdekshmërinë) duke pjesëtuar grupin me popullsinë e mbyllur në vitin 2011; koeficientët u llogaritën për vitin dhe iu caktuan moshës së arritur nga secili grup në mes të periudhës së tij të ekspozimit. Skeduli i koeficientëve empirikë sipas moshës më pas u sheshua duke përdorur një funksion multieksponecial në programin Eksel përpunuar nga (Wilson 2010).

I ngjajshëm me ISF u llogarit një matës përmbledhës i intensitetit të emigrimit, Indeksi Sintetik i Migrimit (ISM; Rogers dhe Castro 1980) si shumë e koeficientëve specifikë sipas moshave. Ky matës mund të interpretohet si numri i emigrimeve që një individ pritët të provojë nëse ai do t'i nënshtrohet gjithë jetën e tij koeficientëve të migrimit të vrojtuar në periudhën e referencës. Për lehtësimin e krahasimeve, skedulet e koeficientëve sipas moshës të treguara në Figurën 6 u normalizuan në një Indeks Sintetik të Migrimit njësi.

Vlerësimet e emigrimit nga qarqet ndërmjet dy Censuseve, bazuar në Censusin e vitit 2011:

Normat pesë-vjeçare të tranzicionit (vdekshmëria neto) u vlerësuan me anë të tabelës së jetës (metoda e të mbijetuarve) nga Censuset e viteve 2001 dhe 2011 e përmendur më lart, me një ndryshim të dukshëm, që grupi i migrantëve u përftua si mbetja ndërmjet popullsisë të qarqeve të projektuara të mbyllur në të ardhmen dhe popullsisë së vëzhguar të Shqipërisë në vitin 2011, i cili u rishpërnda sipas qarqeve të banimit në vitin 2001. Fëmijët e llogaritur të lindur gjatë intervalit ndërmjet dy censuseve u rishpërndanë sipas qarkut të lindjes. Koeficientët e migrimit 10 vjeçar (duke iu referuar grupmoshave 5 vjeçare në mes të intervalit ndërmjet dy censuseve) u transformuan në koeficientë të migracionit 5 vjeçar.

Vlerësimet e normave të migrimit brenda vendit ndërmjet qarqeve, bazuar në Censusin e vitit 2011.

Koeficientët pesë vjeçar të migrimit ndërmjet qarqeve (duke marrë parasysh vdekshmërinë dhe emigrimin) u përfatuan nga Censusi i vitit 2011 duke pjesëtuar numrin e emigrantëve brenda vendit të regjistruar me totalin e popullsisë së qarqeve (i rishpërndarë sipas vendbanimit në vitin 2006).

Tabela e jetëgjatësisë për vitin 2011:


Ne kombinuam vlerësimin e ADHS-së për vdekshmërinë foshnjore dhe të fëmijëve duke iu referuar vitit 2008, rishpërndamë nivelin sipas gjinisë në përputhje me raportin gjinor të vdekshmërisë së vëzhguar nga statistikat vitale dhe reduktuam përqindjet për të pasqyruar përmirësimet deri në vitin 2011 të vëzhguara nga këto statistika. Këto nivele të vdekshmërisë për fëmijët më pas u kombinuan me nivelet e moshave të vjetra, që u mbështetën në numrin vjetor të vdekjeve të regjistruara në periudhën 2010-2012 dhe popullsinë e Censusit të vitit 2011.

SHTOJCA 2: NDRYSHIMI DEMOGRAFIK NË QARQET E SHQIPËRISË (ANALIZË E DETAJUAR)

Rënia e popullsisë që nga viti 2001 përfshin të gjitha qarqet përveç Durrësit dhe Tiranës, ku numri i banorëve u rrit respektivisht me një koeficient vjetor prej 0.3% dhe 1%, rrjedhojë e emigrimit të ulët dhe migrimit të brendshëm të lartë (Shtojca, Tabela 1). Koeficienti i rënies demografike ishte të paktën 1% në vit në Jug (veçanërisht në Gjirokastrë dhe Berat, në sajë të migrimit të jashtëm dhe të brendshëm), dhe në Veri (Kukës dhe Dibër, duke provuar koeficientë të lartë të largimeve të brendshme).

Format më të çrregullta të piramidës sipas gjinisë dhe moshës u vëzhguan në Gjirokastrë, Shkodër, dhe Lezhë (Figura 20). Struktura e popullsisë në Tiranë dhe Durrës tregon thyerje të piramidave më pak të krahasueshme sepse emigrimi i të rinjve ishte më i ulët dhe u kompensua nga migrimi i brendshëm. Tirana dhe Shkodra janë qarqet e vetme ku gratë janë më të shumta sesa burrat në vitin 2011, duke reflektuar nivelin e ulët të emigrimit dhe nivelin e lartë të migrimit të brendshëm kryesisht të grave nga rajonet e tjera të Shqipërisë.

Figura 20. Piramidat e popullsisë (në %) për qarqet e Shqipërisë për vitet 2001 dhe 2011



Dallimet gjeografike në varësinë e të rinjve dhe të moshuarve jo vetëm reflektojnë diferencat në emigrimin sipas moshës, por gjithashtu fillimin historik të rënies së lindshmërisë. Jugu e filloi prirjen e rënies në vitet 1960 dhe për pasojë karakterizohet nga koeficientë më të ulët të varësisë të të rinjve dhe nga koeficientë më të lartë të varësisë të të moshuarve (d.m.th më shumë se 30 të moshuar dhe më pak se 30 fëmijë për çdo 100 individë në moshë pune; Shtojca, Tabela 1), veçanërisht në Gjirokastrë, Korçë, Vlorë dhe Berat. Këto qarqen dryshuan me shpejtësi nga një varësi dominuese e moshës së re tek ajo e moshës së vjetër. Në Veri të Shqipërisë, koeficienti i varësisë të të rinjve kulmon tek më shumë se 40% në Dibër dhe Kukës, gjë që dëshmon për përfundimin e vonë të tranzicionit të parë demografik.

Duke pasur parasysh nivelin e ulët të vdekshmërisë në moshat e rritura, gjeografia e vdekshmërisë përcaktohet nga diferencat në vdekshmërinë e fëmijëve dhe të foshnjave. Megjithëse niveli pësoi rënie të madhe gjatë dyzet viteve të fundit, diferencat territoriale mbetën të pandryshuara (Gjonça 2001; Lerch et al 2010). Vlerësimet indirekte nga Censusi i fundit për vitin 2008 konfirmojnë një vdekshmëri fëmijësh më të lartë në Veri, me nivele afër ose më shumë se 30 vdekje për çdo 1.000 lindje të gjalla. Në Jug dhe në qarqet e Tiranës dhe Durrësit, kishte më pak se sa 20 vdekje (Shtojca, Tabela 1).

Që nga viti 1989, Shqipëria ka provuar një konvergjencë rajonale në nivelet e lindshmërisë me rënie të forta në rajonet periferike dhe të largëta (me rreth 1 fëmijë gjatë viteve 1990). Indeksi sintetik i fekonditetit në vitin 2001 për qarqet ishte afër me nivelin e zëvendësimit të gjeneratave (përveç Kukësit dhe Dibrës, ku niveli ishte afër me 3 fëmijë; Lerch et al. 2010). Konvergjenca vazhdoi në dekadën e fundit, e pasqyrur me statistika vitale dhe vlerësime indirekte nga Censusi i vitit 2011 (duke përdorur metodën e fëmijëve të vet; Tabela 2). Nëse Kukësi dhe Dibra vazhduan të arrijnë tendencën (me rënien e të paktën një fëmije), rënia ishte e ngjashme në të gjitha qarqet (pak më pak se 0,5 ose rreth 5 fëmijë për 10 gra, në moshë lindje). Lindshmëria arriti nivele të ulta që nuk garantonin më zëvendësimin demografik të gjeneratave aktuale në të ardhmen në të gjitha qarqet. Indeksi sintetik i fekonditetit varion ndërmjet 1,6 në Gjirokastrë dhe 2,1 në Dibër.

Tabela 1 e Shtojcës: Treguesit demografikë për qarqet e Shqipërisë, 2001-2011

Treguesi	Detajet	Periudha e Referencës	Qarku											
			BE	DI	DU	ELB	FI	GJ	KOR	KUK	LE	SHK	TIR	VL
Popullsia		2011	141.944	137.047	262.785	295.827	310.331	72.176	220.357	85.292	134.027	215.347	749.365	75.640
Niveli i irritjes	Vjetor	2001-11	-0,013	-0,014	0,003	-0,009	-0,009	-0,019	-0,008	-0,012	-0,007	-0,008	0,010	-0,004
Raporti gjinor	Gjithsej	2011	1,01	1,04	1,01	1,01	1,02	1,03	1,02	1,02	1,00	0,98	0,98	1,01
	Moshat 0-4	2011	1,09	1,16	1,15	1,04	1,13	1,11	1,09	1,13	1,13	1,11	1,09	1,06
	Moshat 20-29	2011	1,24	1,22	1,07	1,17	1,21	1,28	1,21	1,08	1,12	1,10	0,94	1,11
	Moshat 30-44	2011	0,88	0,87	0,93	0,93	0,89	0,90	0,95	0,85	0,89	0,83	0,94	0,93
KVR (në %)	Moshat 0-14 / 15-64	2011	29	34	38	34	32	31	31	30	29	28	25	27
KVM (në %)	Moshat 65+ / 15-64	2011	18	15	14	15	16	15	15	16	18	19	24	21
Vdekshmëria tek fëmijët	(p.1000)	2001	14	27	19	23	20	22	18	36	26	25	16	14
ISF	Statistikat vitale	2011	1,9	2,1	1,8	1,8	1,9	1,7	1,7	2,2	1,9	1,7	1,6	1,7
ISF	Met. e fëmij. të vet	2010-11	1,8	1,9	1,8	1,7	1,8	1,6	1,7	2,1	1,9	2,0	1,9	1,8
ISF	Diferenca		0,5	1,0	0,4	0,7	0,4	0,4	0,5	1,2	0,4	0,3	0,2	0,4
ISM jashtë vendit	Meshkuj	2007-11	2,0	1,5	1,2	1,8	1,8	2,1	1,5	1,2	2,1	1,6	0,7	1,4
	Femra	2007-11	1,8	1,3	1,4	1,6	1,7	2,0	1,4	1,1	2,1	1,6	0,8	1,4
% e shpërndarjes së imigrantëve	Meshkuj	2007-11	6,2	4,3	8,2	11,2	14,4	2,9	8,7	1,1	5,7	5,6	21,1	10,7
	Femra	2007-11	4,2	1,4	8,1	9,0	10,7	3,9	10,2	0,4	4,9	5,8	26,2	15,1
ISM e brendshme	Meshkuj	2007-11	0,6	1,2	0,3	0,4	0,4	0,9	0,4	1,2	0,4	0,4	0,2	0,3
	Femra	2007-11	0,8	1,4	0,4	0,5	0,7	1,2	0,5	1,3	0,6	0,5	0,2	0,5
% e shpërndarjes së migrantëve të brendshëm	Meshkuj	2007-11	1,9	1,6	15,9	3,5	5,3	1,4	2,9	1,2	4,2	3,4	53,7	5,1
	Femra	2007-11	2,3	1,7	14,4	4,0	6,0	1,3	3,4	1,1	4,4	4,0	52,5	5,1

Burimet: Censusi 2001 dhe 2011, statistikat vitale.

Diferencat në vlerësimet e lindshmërisë nga statistikat vitale dhe Censusi i 2011 janë të vogla krahasuar me ato të viteve 2000-01, që konfirmojnë përmirësimet në matje. Statistikat vitale në mënyrë konsistente tregojnë një nivel pak më të lartë, përveç Tiranës dhe Shkodrës, ku nënvlerësojnë lindshmërinë me 0,3 fëmijë krahasuar me vlerësimet e Censurit. Sipas Censurit 2011, lindshmëria në fakt pësoi rënien më të vogël nëqarkun e Tiranës që nga viti 2001, që është në përputhje me trendin gjatë viteve 1990 (Lerch et al. 2010). Kjo mund të shpjegohet nga niveli i lartë i migrimit të brendshëm të grave ose çifteve të reja për të krijuar familjen e tyre në qendrën social ekonomike të Shqipërisë (Lerch 2013). Megjithatë, këto gra, mund të regjistrojnë lindjet e tyre nëqarkun ku morën qëndrimin e ligjshëm, gjë e cila mund të shpjegojë diferencën me shifrat e Censurit bazuar në vendbanimin aktual. Një model i ngjashëm mund të shpjegojë divergjencën në Shkodër. Pra, migrimi i brendshëm ndikon në nivelet e lindshmërisë rajonale në Shqipëri. Për rrjedhojë, për parashikimet e qarqeve u përdorën vlerësimet indirekte të lindshmërisë për Tiranën dhe Shkodrën.

Tabela 2 gjithashtu raporton nivelet e emigrimit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar tëë qarqeve për periudhën 2007-11, që janë vlerësuar indirekt nga Censuset e viteve 2001 dhe 2011 (shihni Metodën tek Shtojca). Për garantimin e krahasueshmërisë janë dhënë treguesit e standardizuar të riskut të emigrimit (që i referohen një periudhe 5 vjeçare): Indeksi Sintetik i Migrimit tregon numrin e emigrimeve që mund të presë një individ nëse nivelet aktuale sipas grupmoshave mbeten të pandryshuara në të ardhmen.


Largimet jashtëvendit dominojnë qartësisht emigrimin brendavendit në të gjitha qarqet, përveç atyre të Kukësit dhe Dibrës. Nëse emigrimi i brendshëm ishte shumë i lartë që nga viti 1989 nga këto rajone periferike dhe malore, nivelet e emigrimit aktualisht janë rritur gjithashtu, gjë e cila konfirmon shpërndarjen territoriale të mundësive për emigrim në të gjithë Shqipërinë. Megjithatë gjeografia e largimeve jashtë shtetit nuk ndryshoi shumë deri në vitin 2001. Niveli mbeti më i lartë në Jug dhe në bregdet. (ISM është më madhe se 1,5 në Gjirokastrë, Berat, Lezhë dhe Fier) dhe më e ulëta në rajonet kryesore të origjinës dhe destinacionit të lëvizjeve të brendshme (qarqet e Veriut të Kukësit dhe Dibrës, dhe respektivisht Durrësit dhe Tiranës). Krahas kësaj, profili i grupmoshës për migrim është relativisht i ngjashëm nëpër qarqe, dhe burrat dhe gratë emigronin në të njëjtën masë. Kjo dëshmon për transformimin aktual të modelit shqiptar të migrimit në një fenomen i dominuar nga familja.

Sipas Censurit të fundit, të kthyerit nga jashtë shtetit (2009-2011) u vendosën kryesisht në qarqet më të urbanizuara të tilla si Tirana (ku u sistemuan 21% të meshkujve të kthyer), Durrës (8%), Elbasan (11%), Korçë (9%) dhe në qarqet përgjatë bregdetit Adriatik, kryesisht në Vlorë (11%) dhe Fier (14%).

Si me lindshmërinë, ka pasur një konvergjencë gjeografike në nivelet e migrimit të brendshëm ndërmjet qarqeve, ku të gjitha ato provuan një indeks sintetik ndërmjet 0,4 dhe 0,8 në vitet 2007-11. Dibra dhe Kukësi shfaqën nivelet më të larta të largimeve (me një ISM të paktën 1,2) megjithëse këto nivele ishin edhe më të larta në periudhën 2000-01. Krahas kësaj, largimet nga qarqet ishin gjithashtu të larta në Berat dhe Gjirokastrë, të cilat gjatë viteve 1990 patën humbje të popullsisë drejt destinacioneve të vendeve të huaja. Migrantët e kthyer nga Greqia nga këto rajone shpesh sistemohen në bregdet ose në zonën Tiranë-Durrës. Pra shpopullimi i Veriut dhe Jugut nga migrimi i brendshëm dhe ai ndërkombëtar gjatë viteve 1990 konfirmohet në dekadën e fundit.

Ndryshe nga rasti i migrimit ndërkombëtar, është interesante të vërehet se në të gjitha qarqet (përveç Dibrës, Kukësit dhe Tiranës) migrimi i brendshëm është më i lartë ndër femrat sesa meshkujt. Kjo shpjegohet kryesisht nga nivelet e larta të femrave në moshat kulmore të migrimit. Deri në 25% të grave të grupmoshave nga 15 deri 19 vjeç në vitin 2006 banonin në njëqark tjetër në vitin 2011. Meshkujt paraqitën një profil shumë më të sheshtë të migrimit jashtë qarqeve që kulmon nga 5 deri 10%. Një krahasim i niveleve ndërmjet qarqeve të migrimit jashtë tyre, që vlerësohet në nivel kombëtar për dymbëdhjetë muajt përpara Censuseve të viteve 2001 dhe 2011⁵, konfirmon një përzgjedhje demografike fuqimisht në rritje të migrimit të brendshëm më shumë sesa ai i emigrimit ndërkombëtar (Figura 21).

⁵ Censusi i mëparshëm nuk raporton migrim të brendshëm për një periudhë pesë vjeçare.

Figura 21. Normat e migrimit të jashtëm ndërmjet qarqeve sipas grupmoshës dhe gjinisë, 2000-01 dhe 2010-11

Burimet: Censusi 2001, 2011.

Ndërsa në periudhën 2000-01 familje të tëra u larguan nga rajonet e tyre të origjinës (d.m.th profili i moshës ishte i sheshtë), largimet kryesisht përfshinë të rritur më pak se 30 vjeç dhe veçanërisht femra të moshave nga 18 deri 22 vjeç (në vitet 2010-11). Pra, migrimi i brendshëm gjithnjë e më shumë ndodh gjatë fazave të jetës që karakterizohen nga tranzicione të mëdha, të tilla si fillimi i një pune, arsim më i lartë ose një martesë. Si me migrimin ndërkombëtar, për rrjedhojë ne mund të dalim në përfundimin se migrimi i brendshëm u transformua nga i motivuar nga kriza tek i motivuar nga mundësitë ose kërkimi i komoditeteve më të mira. Krahas kësaj, përzgjedhja demografike e fortë kryesisht e migranteve femra duhet të ndikojë nivelet rajonale të riprodhimit. Kthimet e brendshme janë të rralla.

Përqendrimi gjeografik i migrimit të brendshëm nuk ndryshoi në krahasim me vitet 1990. Fokusi i tij në Tiranë dhe Durrës, ku drejtohen më shumë se gjysma dhe 15% e migrantëve gjatë viteve 2000, është më i fortë në krahasim me gjeografinë e imigrimit. Pra, migrimi i brendshëm mbetet një lëvizje nga fshati drejt qytetit në vitet 2000, edhe pse shumë individë u sistemuan në zonat rurale në rrethinat e qyteteve. Kombinuar me migrimin e kthimit, kjo çoi në një rritje të shpejtë të procesit të urbanizimit, më shumë se 50% e popullsisë banon në zona urbane zyrtare në vitin 2011, nga 36% që ishte në vitin 1989. Ne mund të dalim në përfundimin se migrimi i brendshëm dhe ndërkombëtar në shkallë të gjerë nuk ishte faktori i vetëm i ndryshimit të popullsisë në Shqipëri që nga viti 1989, por gjithashtu rriti përqendrimin e tij territorial në qarqet më të urbanizuara. Më konkretisht, konfirmohet tërheqja drejt Tiranës dhe Durrësit: 36% e popullsisë kombëtare jetonte aty në vitin 2011 kundrejt 27% në vitin 2001 dhe 22% në vitin 1989.

SHTOJCA 3: TABELAT E HIPOTEZAVE TË PROJEKSIONEVE TË POPULLSISË NË NIVEL KOMBËTAR

Shtojca, Tabela 2. Koeficientët specifikë të vdekshmërisë sipas gjinisë, hipoteza e mesme e vdekshmërisë, 2011 - 2031

Mosha	2011		2016		2021		2026		2031	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
0	0,01585	0,01285	0,01195	0,00994	0,00900	0,00769	0,00678	0,00611	0,00511	0,00486
1	0,00575	0,00476	0,00507	0,00430	0,00446	0,00389	0,00403	0,00351	0,00365	0,00318
2	0,00207	0,00175	0,00183	0,00158	0,00161	0,00143	0,00145	0,00129	0,00131	0,00117
3	0,00074	0,00064	0,00066	0,00058	0,00058	0,00053	0,00052	0,00048	0,00047	0,00043
4	0,00074	0,00064	0,00066	0,00058	0,00058	0,00053	0,00052	0,00048	0,00047	0,00043
5	0,00074	0,00064	0,00067	0,00059	0,00061	0,00055	0,00056	0,00052	0,00052	0,00050
6	0,00074	0,00064	0,00067	0,00059	0,00061	0,00055	0,00056	0,00052	0,00052	0,00050
7	0,00074	0,00064	0,00067	0,00059	0,00061	0,00055	0,00056	0,00052	0,00052	0,00050
8	0,00032	0,00033	0,00029	0,00031	0,00026	0,00028	0,00024	0,00027	0,00023	0,00026
9	0,00032	0,00032	0,00029	0,00029	0,00026	0,00027	0,00024	0,00026	0,00023	0,00024
10	0,00032	0,00030	0,00029	0,00028	0,00026	0,00026	0,00024	0,00024	0,00023	0,00023
11	0,00032	0,00028	0,00029	0,00026	0,00026	0,00024	0,00024	0,00023	0,00023	0,00022
12	0,00032	0,00027	0,00029	0,00025	0,00026	0,00023	0,00025	0,00022	0,00023	0,00021
13	0,00035	0,00027	0,00032	0,00025	0,00029	0,00023	0,00026	0,00022	0,00025	0,00021
14	0,00040	0,00029	0,00037	0,00027	0,00033	0,00025	0,00031	0,00023	0,00028	0,00022
15	0,00047	0,00031	0,00042	0,00028	0,00038	0,00026	0,00035	0,00025	0,00033	0,00024
16	0,00054	0,00033	0,00049	0,00030	0,00044	0,00028	0,00041	0,00026	0,00038	0,00025
17	0,00063	0,00035	0,00057	0,00032	0,00051	0,00029	0,00048	0,00028	0,00044	0,00027
18	0,00069	0,00036	0,00063	0,00033	0,00057	0,00031	0,00053	0,00029	0,00049	0,00028
19	0,00073	0,00037	0,00066	0,00034	0,00060	0,00032	0,00055	0,00030	0,00051	0,00029
20	0,00077	0,00038	0,00070	0,00035	0,00063	0,00033	0,00058	0,00031	0,00054	0,00029
21	0,00081	0,00039	0,00073	0,00036	0,00066	0,00034	0,00062	0,00032	0,00057	0,00030
22	0,00086	0,00040	0,00077	0,00037	0,00070	0,00034	0,00065	0,00033	0,00060	0,00031
23	0,00090	0,00041	0,00081	0,00038	0,00073	0,00035	0,00068	0,00034	0,00063	0,00032
24	0,00093	0,00042	0,00084	0,00039	0,00076	0,00036	0,00071	0,00034	0,00065	0,00032
25	0,00097	0,00043	0,00087	0,00039	0,00079	0,00036	0,00073	0,00035	0,00068	0,00033
26	0,00101	0,00043	0,00091	0,00040	0,00082	0,00037	0,00076	0,00035	0,00071	0,00033
27	0,00105	0,00044	0,00094	0,00041	0,00085	0,00038	0,00079	0,00036	0,00073	0,00034
28	0,00110	0,00046	0,00099	0,00042	0,00090	0,00039	0,00083	0,00037	0,00077	0,00035
29	0,00117	0,00048	0,00106	0,00044	0,00095	0,00041	0,00088	0,00039	0,00082	0,00037
30	0,00124	0,00051	0,00112	0,00047	0,00101	0,00043	0,00094	0,00041	0,00087	0,00039
31	0,00132	0,00053	0,00119	0,00049	0,00108	0,00045	0,00100	0,00043	0,00093	0,00041
32	0,00140	0,00056	0,00127	0,00052	0,00115	0,00048	0,00106	0,00046	0,00099	0,00043
33	0,00150	0,00060	0,00135	0,00056	0,00122	0,00051	0,00114	0,00049	0,00105	0,00046
34	0,00161	0,00065	0,00146	0,00060	0,00132	0,00056	0,00122	0,00053	0,00113	0,00050
35	0,00173	0,00071	0,00156	0,00065	0,00141	0,00060	0,00131	0,00057	0,00122	0,00055
36	0,00186	0,00077	0,00168	0,00071	0,00152	0,00066	0,00141	0,00062	0,00131	0,00059
37	0,00200	0,00084	0,00181	0,00077	0,00163	0,00071	0,00151	0,00068	0,00140	0,00064

Mosha	2011		2016		2021		2026		2031	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
38	0,00209	0,00090	0,00189	0,00083	0,00171	0,00076	0,00158	0,00073	0,00147	0,00069
39	0,00213	0,00096	0,00192	0,00088	0,00174	0,00081	0,00161	0,00077	0,00150	0,00074
40	0,00217	0,00102	0,00196	0,00094	0,00177	0,00087	0,00164	0,00082	0,00152	0,00078
41	0,00221	0,00108	0,00200	0,00100	0,00180	0,00092	0,00167	0,00088	0,00155	0,00083
42	0,00225	0,00116	0,00203	0,00107	0,00184	0,00098	0,00170	0,00093	0,00158	0,00089
43	0,00236	0,00124	0,00213	0,00114	0,00193	0,00105	0,00179	0,00100	0,00166	0,00095
44	0,00255	0,00133	0,00230	0,00122	0,00208	0,00113	0,00193	0,00107	0,00179	0,00102
45	0,00275	0,00143	0,00248	0,00132	0,00224	0,00121	0,00208	0,00115	0,00193	0,00110
46	0,00297	0,00153	0,00268	0,00141	0,00242	0,00130	0,00225	0,00124	0,00208	0,00118
47	0,00320	0,00165	0,00289	0,00152	0,00262	0,00140	0,00242	0,00133	0,00225	0,00127
48	0,00345	0,00177	0,00312	0,00164	0,00282	0,00151	0,00262	0,00144	0,00243	0,00137
49	0,00372	0,00192	0,00337	0,00177	0,00304	0,00163	0,00282	0,00155	0,00262	0,00148
50	0,00401	0,00207	0,00363	0,00191	0,00328	0,00177	0,00304	0,00168	0,00282	0,00160
51	0,00433	0,00224	0,00391	0,00207	0,00354	0,00191	0,00328	0,00182	0,00304	0,00173
52	0,00467	0,00243	0,00422	0,00224	0,00381	0,00206	0,00354	0,00196	0,00328	0,00187
53	0,00507	0,00260	0,00458	0,00240	0,00414	0,00222	0,00384	0,00211	0,00356	0,00200
54	0,00554	0,00277	0,00501	0,00256	0,00453	0,00236	0,00420	0,00225	0,00389	0,00214
55	0,00606	0,00296	0,00548	0,00273	0,00495	0,00252	0,00459	0,00239	0,00426	0,00228
56	0,00663	0,00315	0,00599	0,00291	0,00542	0,00268	0,00502	0,00255	0,00466	0,00243
57	0,00725	0,00336	0,00655	0,00310	0,00592	0,00286	0,00549	0,00272	0,00509	0,00259
58	0,00788	0,00363	0,00712	0,00335	0,00644	0,00309	0,00597	0,00294	0,00553	0,00279
59	0,00851	0,00398	0,00769	0,00367	0,00695	0,00339	0,00644	0,00322	0,00598	0,00306
60	0,00919	0,00436	0,00865	0,00415	0,00814	0,00394	0,00786	0,00381	0,00759	0,00368
61	0,00992	0,00478	0,00934	0,00454	0,00879	0,00432	0,00849	0,00417	0,00819	0,00403
62	0,01071	0,00524	0,01008	0,00498	0,00949	0,00473	0,00916	0,00457	0,00884	0,00441
63	0,01179	0,00587	0,01110	0,00558	0,01045	0,00531	0,01008	0,00513	0,00974	0,00495
64	0,01323	0,00673	0,01245	0,00640	0,01172	0,00609	0,01132	0,00588	0,01093	0,00568
65	0,01485	0,00772	0,01398	0,00734	0,01316	0,00698	0,01270	0,00674	0,01226	0,00651
66	0,01666	0,00886	0,01568	0,00842	0,01476	0,00801	0,01425	0,00773	0,01376	0,00747
67	0,01868	0,01015	0,01759	0,00966	0,01656	0,00918	0,01599	0,00887	0,01544	0,00856
68	0,02089	0,01166	0,01967	0,01109	0,01851	0,01054	0,01788	0,01018	0,01726	0,00983
69	0,02328	0,01340	0,02192	0,01275	0,02063	0,01212	0,01992	0,01170	0,01923	0,01130
70	0,02594	0,01541	0,02442	0,01465	0,02299	0,01394	0,02220	0,01345	0,02143	0,01299
71	0,02889	0,01771	0,02720	0,01684	0,02560	0,01601	0,02472	0,01546	0,02387	0,01493
72	0,03217	0,02034	0,03028	0,01935	0,02851	0,01840	0,02752	0,01776	0,02657	0,01715
73	0,03591	0,02337	0,03380	0,02222	0,03182	0,02113	0,03072	0,02041	0,02966	0,01970
74	0,04018	0,02685	0,03782	0,02553	0,03561	0,02428	0,03438	0,02344	0,03319	0,02263
75	0,04493	0,03082	0,04230	0,02931	0,03982	0,02788	0,03845	0,02691	0,03712	0,02599
76	0,05022	0,03537	0,04728	0,03364	0,04451	0,03199	0,04298	0,03088	0,04149	0,02982

Shtojca, Tabela 2. Koeficientët specifikë të vdekshmërisë sipas gjinisë, hipoteza e mesme e vdekshmërisë, 2011 - 2031

Mosha	2011		2016		2021		2026		2031	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
77	0,05610	0,04056	0,05281	0,03857	0,04972	0,03668	0,04801	0,03541	0,04635	0,03419
78	0,06316	0,04663	0,05946	0,04435	0,05597	0,04217	0,05404	0,04072	0,05218	0,03931
79	0,07164	0,05376	0,06744	0,05112	0,06349	0,04862	0,06130	0,04694	0,05918	0,04532
80	0,08116	0,06190	0,07640	0,05886	0,07193	0,05598	0,06945	0,05405	0,06705	0,05218
81	0,09182	0,07118	0,08644	0,06769	0,08138	0,06437	0,07857	0,06215	0,07586	0,06001
82	0,10372	0,08173	0,09765	0,07772	0,09193	0,07392	0,08875	0,07136	0,08569	0,06890
83	0,11547	0,09266	0,10871	0,08812	0,10234	0,08380	0,09881	0,08091	0,09540	0,07811
84	0,12675	0,10375	0,11932	0,09866	0,11233	0,09383	0,10845	0,09059	0,10471	0,08746
85	0,13895	0,11599	0,13081	0,11031	0,12314	0,10490	0,11889	0,10128	0,11479	0,09778
86	0,15212	0,12947	0,14320	0,12312	0,13482	0,11709	0,13016	0,11305	0,12567	0,10915
87	0,16629	0,14426	0,15655	0,13719	0,14738	0,13047	0,14229	0,12596	0,13738	0,12162
88	0,17801	0,15810	0,16758	0,15035	0,15776	0,14299	0,15232	0,13805	0,14706	0,13329
89	0,18672	0,17053	0,17578	0,16218	0,16549	0,15423	0,15977	0,14890	0,15426	0,14376
90	0,19576	0,18373	0,18429	0,17472	0,17350	0,16616	0,16751	0,16042	0,16173	0,15489
91	0,20513	0,19770	0,19311	0,18801	0,18180	0,17879	0,17553	0,17262	0,16947	0,16667
92	0,21482	0,21246	0,20224	0,20204	0,19039	0,19214	0,18382	0,18551	0,17748	0,17911
93	0,23249	0,22674	0,21887	0,21563	0,20605	0,20506	0,19894	0,19798	0,19207	0,19115
94	0,25939	0,24037	0,24419	0,22859	0,22989	0,21739	0,22195	0,20988	0,21429	0,20264
95	0,28822	0,25455	0,27134	0,24208	0,25545	0,23021	0,24663	0,22227	0,23812	0,21460
96	0,31889	0,26928	0,30021	0,25608	0,28262	0,24353	0,27287	0,23512	0,26345	0,22701
97	0,35120	0,28453	0,33063	0,27058	0,31126	0,25732	0,30052	0,24844	0,29015	0,23987
98	0,38494	0,30029	0,36239	0,28557	0,34117	0,27157	0,32939	0,26220	0,31802	0,25315
99+	0,40226	0,30835	0,37870	0,29324	0,35652	0,27886	0,34421	0,26924	0,33233	0,25995

Shtojca, Tabela 3. Koeficientët specifikë të lindshmërisë, hipoteza e ulët e lindshmërisë, 2011 - 2031

Mosha	2011	2016	2021	2026	2031
15	0,0000	0,0000	0,0000	0,0000	0,0000
16	0,0016	0,0007	0,0003	0,0001	0,0000
17	0,0091	0,0053	0,0029	0,0015	0,0006
18	0,0251	0,0168	0,0106	0,0065	0,0033
19	0,0479	0,0353	0,0249	0,0170	0,0102
20	0,0737	0,0583	0,0445	0,0328	0,0224
21	0,0982	0,0820	0,0664	0,0520	0,0394
22	0,1182	0,1028	0,0873	0,0717	0,0590
23	0,1318	0,1183	0,1042	0,0888	0,0785
24	0,1384	0,1274	0,1154	0,1014	0,0954
25	0,1387	0,1301	0,1204	0,1084	0,1076
26	0,1336	0,1271	0,1196	0,1099	0,1143
27	0,1246	0,1198	0,1142	0,1065	0,1155
28	0,1131	0,1096	0,1053	0,0993	0,1119
29	0,1002	0,0975	0,0942	0,0897	0,1045
30	0,0871	0,0849	0,0822	0,0788	0,0946
31	0,0743	0,0724	0,0702	0,0675	0,0833
32	0,0624	0,0607	0,0587	0,0566	0,0716
33	0,0517	0,0501	0,0483	0,0465	0,0602
34	0,0423	0,0408	0,0391	0,0376	0,0497
35	0,0342	0,0328	0,0312	0,0299	0,0403
36	0,0274	0,0260	0,0246	0,0235	0,0322
37	0,0217	0,0205	0,0191	0,0182	0,0253
38	0,0171	0,0160	0,0147	0,0139	0,0197
39	0,0133	0,0123	0,0112	0,0106	0,0151
40	0,0103	0,0094	0,0085	0,0079	0,0115
41	0,0080	0,0072	0,0064	0,0059	0,0086
42	0,0061	0,0054	0,0047	0,0043	0,0064
43	0,0046	0,0041	0,0035	0,0032	0,0047
44	0,0035	0,0030	0,0026	0,0023	0,0035
45	0,0026	0,0023	0,0019	0,0017	0,0025
46	0,0020	0,0017	0,0014	0,0012	0,0018
47	0,0015	0,0012	0,0010	0,0009	0,0013
48	0,0011	0,0009	0,0007	0,0006	0,0009
49	0,0008	0,0007	0,0005	0,0004	0,0007
ISF	1,73	1,58	1,44	1,30	1,40

Shtojca, Tabela 4. Koeficientët specifikë të lindshmërisë, hipoteza e mesme e lindshmërisë, 2011 – 2031

Mosha	2011	2016	2021	2026	2031
15	0,0000	0,0000	0,0000	0,0000	0,0000
16	0,0016	0,0011	0,0008	0,0005	0,0003
17	0,0091	0,0070	0,0054	0,0039	0,0028
18	0,0251	0,0203	0,0167	0,0132	0,0103
19	0,0479	0,0407	0,0347	0,0292	0,0242
20	0,0737	0,0648	0,0571	0,0501	0,0436
21	0,0982	0,0887	0,0802	0,0728	0,0655
22	0,1182	0,1091	0,1007	0,0937	0,0867
23	0,1318	0,1239	0,1162	0,1104	0,1042
24	0,1384	0,1322	0,1258	0,1212	0,1164
25	0,1387	0,1341	0,1291	0,1259	0,1224
26	0,1336	0,1306	0,1271	0,1250	0,1226
27	0,1246	0,1230	0,1207	0,1194	0,1180
28	0,1131	0,1125	0,1112	0,1105	0,1097
29	0,1002	0,1004	0,0999	0,0995	0,0991
30	0,0871	0,0877	0,0877	0,0875	0,0872
31	0,0743	0,0752	0,0756	0,0753	0,0751
32	0,0624	0,0634	0,0640	0,0637	0,0633
33	0,0517	0,0527	0,0533	0,0530	0,0525
34	0,0423	0,0432	0,0439	0,0434	0,0429
35	0,0342	0,0350	0,0356	0,0351	0,0345
36	0,0274	0,0281	0,0286	0,0281	0,0275
37	0,0217	0,0223	0,0228	0,0222	0,0216
38	0,0171	0,0176	0,0179	0,0174	0,0168
39	0,0133	0,0137	0,0140	0,0135	0,0129
40	0,0103	0,0106	0,0109	0,0104	0,0099
41	0,0080	0,0082	0,0084	0,0079	0,0075
42	0,0061	0,0063	0,0064	0,0060	0,0056
43	0,0046	0,0048	0,0049	0,0045	0,0042
44	0,0035	0,0036	0,0037	0,0034	0,0031
45	0,0026	0,0027	0,0028	0,0025	0,0023
46	0,0020	0,0020	0,0021	0,0019	0,0017
47	0,0015	0,0015	0,0015	0,0014	0,0012
48	0,0011	0,0011	0,0011	0,0010	0,0009
49	0,0008	0,0008	0,0008	0,0007	0,0006
ISF	1,73	1,67	1,61	1,55	1,50

Shtojca, Tabela 5. Koeficientët specifikë të lindshmërisë, hipoteza e lartë e lindshmërisë, 2011 – 2031

Mosha	2011	2016	2021	2026	2031
15	0,0000	0,0000	0,0000	0,0000	0,0000
16	0,0016	0,0013	0,0010	0,0008	0,0006
17	0,0091	0,0078	0,0067	0,0056	0,0048
18	0,0251	0,0227	0,0203	0,0181	0,0161
19	0,0479	0,0449	0,0418	0,0387	0,0356
20	0,0737	0,0711	0,0682	0,0649	0,0616
21	0,0982	0,0970	0,0952	0,0929	0,0901
22	0,1182	0,1190	0,1191	0,1185	0,1172
23	0,1318	0,1349	0,1372	0,1387	0,1395
24	0,1384	0,1436	0,1482	0,1520	0,1551
25	0,1387	0,1456	0,1520	0,1579	0,1631
26	0,1336	0,1417	0,1496	0,1570	0,1640
27	0,1246	0,1334	0,1421	0,1506	0,1588
28	0,1131	0,1220	0,1311	0,1401	0,1490
29	0,1002	0,1090	0,1179	0,1270	0,1360
30	0,0871	0,0952	0,1037	0,1124	0,1213
31	0,0743	0,0817	0,0895	0,0976	0,1060
32	0,0624	0,0690	0,0759	0,0833	0,0909
33	0,0517	0,0574	0,0635	0,0699	0,0768
34	0,0423	0,0471	0,0524	0,0579	0,0639
35	0,0342	0,0383	0,0427	0,0474	0,0525
36	0,0274	0,0307	0,0344	0,0383	0,0426
37	0,0217	0,0245	0,0274	0,0307	0,0342
38	0,0171	0,0193	0,0217	0,0243	0,0272
39	0,0133	0,0151	0,0170	0,0191	0,0214
40	0,0103	0,0117	0,0132	0,0149	0,0168
41	0,0080	0,0090	0,0102	0,0115	0,0130
42	0,0061	0,0069	0,0078	0,0089	0,0100
43	0,0046	0,0053	0,0060	0,0068	0,0077
44	0,0035	0,0040	0,0045	0,0051	0,0058
45	0,0026	0,0030	0,0034	0,0039	0,0044
46	0,0020	0,0023	0,0026	0,0029	0,0033
47	0,0015	0,0017	0,0019	0,0022	0,0025
48	0,0011	0,0013	0,0014	0,0016	0,0019
49	0,0008	0,0009	0,0011	0,0012	0,0014
ISF	1,73	1,82	1,91	2,00	2,09

Shtojca, Tabela 6. Koeficientët specifikë të migrimit ndërkombëtar, hipoteza e ulët e migrimit, 2011 – 2031

Mosha	2011		2016		2021		2026		2031	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
0	0,014045	0,013752	0,009442	0,009298	0,004838	0,004681	0,004838	0,004681	0,004838	0,004681
1	0,027089	0,026300	0,018210	0,017782	0,009331	0,008952	0,009331	0,008952	0,009331	0,008952
2	0,025199	0,024058	0,016940	0,016266	0,008681	0,008189	0,008681	0,008189	0,008681	0,008189
3	0,023451	0,022019	0,015765	0,014888	0,008078	0,007495	0,008078	0,007495	0,008078	0,007495
4	0,021835	0,020167	0,014679	0,013635	0,007522	0,006864	0,007522	0,006864	0,007522	0,006864
5	0,020348	0,018483	0,013679	0,012497	0,007009	0,006291	0,007009	0,006291	0,007009	0,006291
6	0,018989	0,016952	0,012765	0,011462	0,006541	0,005770	0,006541	0,005770	0,006541	0,005770
7	0,017766	0,015561	0,011943	0,010521	0,006120	0,005297	0,006120	0,005297	0,006120	0,005297
8	0,016699	0,014299	0,011226	0,009668	0,005752	0,004867	0,005752	0,004867	0,005752	0,004867
9	0,015820	0,013165	0,010635	0,008901	0,005450	0,004481	0,005450	0,004481	0,005450	0,004481
10	0,015176	0,012186	0,010202	0,008239	0,005228	0,004148	0,005228	0,004148	0,005228	0,004148
11	0,014830	0,011448	0,009969	0,007741	0,005108	0,003897	0,005108	0,003897	0,005108	0,003897
12	0,014849	0,011133	0,009982	0,007527	0,005115	0,003790	0,005115	0,003790	0,005115	0,003790
13	0,015302	0,011510	0,010287	0,007782	0,005271	0,003918	0,005271	0,003918	0,005271	0,003918
14	0,016248	0,012878	0,010922	0,008707	0,005597	0,004383	0,005597	0,004383	0,005597	0,004383
15	0,017718	0,015452	0,011911	0,010448	0,006103	0,005260	0,006103	0,005260	0,006103	0,005260
16	0,019712	0,019257	0,013251	0,013020	0,006790	0,006555	0,006790	0,006555	0,006790	0,006555
17	0,022186	0,024077	0,014914	0,016279	0,007643	0,008195	0,007643	0,008195	0,007643	0,008195
18	0,025054	0,029492	0,016842	0,019941	0,008630	0,010039	0,008630	0,010039	0,008630	0,010039
19	0,028192	0,034972	0,018951	0,023646	0,009711	0,011904	0,009711	0,011904	0,009711	0,011904
20	0,031445	0,039993	0,021139	0,027040	0,010832	0,013613	0,010832	0,013613	0,010832	0,013613
21	0,034648	0,044130	0,023292	0,029838	0,011935	0,015021	0,011935	0,015021	0,011935	0,015021
22	0,037631	0,047113	0,025297	0,031855	0,012963	0,016036	0,012963	0,016036	0,012963	0,016036
23	0,040242	0,048833	0,027052	0,033018	0,013862	0,016622	0,013862	0,016622	0,013862	0,016622
24	0,042356	0,049322	0,028473	0,033348	0,014591	0,016788	0,014591	0,016788	0,014591	0,016788
25	0,043881	0,048710	0,029499	0,032935	0,015116	0,016580	0,015116	0,016580	0,015116	0,016580
26	0,044767	0,047190	0,030094	0,031907	0,015421	0,016063	0,015421	0,016063	0,015421	0,016063
27	0,045000	0,044976	0,030251	0,030409	0,015501	0,015309	0,015501	0,015309	0,015501	0,015309
28	0,044602	0,042277	0,029983	0,028585	0,015364	0,014390	0,015364	0,014390	0,015364	0,014390
29	0,043626	0,039283	0,029327	0,026561	0,015028	0,013371	0,015028	0,013371	0,015028	0,013371
30	0,042145	0,036154	0,028331	0,024445	0,014518	0,012306	0,014518	0,012306	0,014518	0,012306
31	0,040245	0,033015	0,027054	0,022323	0,013863	0,011238	0,013863	0,011238	0,013863	0,011238
32	0,038022	0,029962	0,025560	0,020258	0,013098	0,010199	0,013098	0,010199	0,013098	0,010199
33	0,035569	0,027061	0,023911	0,018297	0,012253	0,009211	0,012253	0,009211	0,012253	0,009211
34	0,032976	0,024357	0,022167	0,016469	0,011359	0,008291	0,011359	0,008291	0,011359	0,008291
35	0,030323	0,021875	0,020385	0,014790	0,010446	0,007446	0,010446	0,007446	0,010446	0,007446
36	0,027682	0,019625	0,018609	0,013269	0,009536	0,006680	0,009536	0,006680	0,009536	0,006680
37	0,025111	0,017609	0,016880	0,011906	0,008650	0,005994	0,008650	0,005994	0,008650	0,005994

Mosha	2011		2016		2021		2026		2031	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
38	0,022656	0,015820	0,015230	0,010697	0,007804	0,005385	0,007804	0,005385	0,007804	0,005385
39	0,020352	0,014248	0,013681	0,009633	0,007011	0,004850	0,007011	0,004850	0,007011	0,004850
40	0,018224	0,012877	0,012251	0,008707	0,006278	0,004383	0,006278	0,004383	0,006278	0,004383
41	0,016289	0,011693	0,010950	0,007906	0,005611	0,003980	0,005611	0,003980	0,005611	0,003980
42	0,014556	0,010679	0,009785	0,007221	0,005014	0,003635	0,005014	0,003635	0,005014	0,003635
43	0,013026	0,009820	0,008756	0,006639	0,004487	0,003342	0,004487	0,003342	0,004487	0,003342
44	0,011697	0,009099	0,007863	0,006152	0,004029	0,003097	0,004029	0,003097	0,004029	0,003097
45	0,010565	0,008502	0,007102	0,005748	0,003639	0,002894	0,003639	0,002894	0,003639	0,002894
46	0,009619	0,008015	0,006466	0,005419	0,003314	0,002728	0,003314	0,002728	0,003314	0,002728
